2. Metoda e pretendimit të 1-rë, ku mjeti i dytë kompjuterik ndërvepron/lidhet (ndërfaqja) me funksionin e kontrollit gramatikor nëpërmjet një ndërfaqeje programimi me aplikacion (application programming interface) .

3. Metoda e pretendimit të 2-të, ku mjeti i dytë kompjuterik është server (enterprise server) dhe serveri mban një shërbim me akses në internet të funksionit të kontrollit gramatikor nëpërmjet ndërfaqjes së programimit me aplikacion.

4. Metoda e pretendimit të 2-të, ku ndërfaqja e programimit me aplikacion lidhet me së paku një aplikacion të palës së tretë, një përpunues fjalësh, një faqe kërkimi në internet, një motor kërkimi, një klient poste elektronike, një aplikacion mesazhesh, një aplikacion blogu, një aplikacion mikro-

blogu, një funksion për menaxhimin e përmbajtjes, një funksion publikimi/botimi dhe një funksion reklamimi.

5. Metoda e pretendimit të 1-rë, ku së paku një version i korrigjuar përfshin një numër pjesësh të korrigjuara të integruara sërish në tekstin e marrë në fillim dhe ku mjeti i dytë kompjuterik merr të gjithë tekstin me gabimet e korrigjuara.

6. Metoda e pretendimit të 1-rë, ku së paku një prej pjesëve të tekstit i jepet palës korresponduese në masën e redaktorëve (specialistë të gjuhës shqipe) për vlerësim në një prej formateve me zgjedhje dhe formateve me përgjigje të shkurtra.

7. Metoda e pretendimit të 1-rë, ku së paku një prej pjesëve të tekstit që përmban gabim të identifikuar ose gabim të mundshëm gramatikor u jepet së paku dy prej numrit të redaktorëve (specialistë të gjuhës shqipe) për vlerësim dhe, nëse vlerësimet që ata sjellin nuk përputhen, atëherë së paku njëri version i tekstit të korrigjuar përfshin vlerësimin e redaktorit të renditjes më të lartë prej së paku dy prej numrit të redaktorëve (specialistë të gjuhës shqipe) .

8. Metoda e pretendimit të 1-rë, ku së paku një prej pjesëve të tekstit që përmban gabim të identifikuar u jepet së paku disave prej numrit të redaktorëve (specialistë të gjuhës shqipe) për vlerësim të gabimit si mënyrë për të dhënë informacion të mëtejshëm për renditjen cilësorë të redaktorëve.

9. Metoda e pretendimit të 1-rë, ku renditja përkatëse e secilit prej redaktorëve bazohet në së paku një prej saktësive të përgjithshme në korrigjimin e gabimeve, në aftësinë për lloje të caktuara gabimesh, në kohë, të qenit në dispozicion dhe në kosto.

10. Metoda e pretendimit të 1-rë, ku së paku një version i korrigjuar është version i nënvizuar me të kuqe.

11. Metoda e pretendimit të 1-rë, që përfshin më tej zbulimin, nga numri i redaktorëve (specialistë të gjuhës shqipe) , e gabimeve të tjera gramatikore që nuk janë gjetur nga zbulimi automatik i funksionit të kontrollit gramatikor në morinë e gabimeve të mundshme gramatikore, dhe korrigjimin, nga numri i redaktorëve, e gabimeve të tjera gramatikore si edhe numrin e gabimeve gramatikore të kategorizuara si gabime të mundshme me siguri të ulët të zbuluara prej funksionit të kontrollit gramatikor.

12. Metoda e pretendimit të 1-rë, ku së paku një prej numrit të mjeteve kompjuterike të redaktorëve është mjet kompjuterik i lëvizshëm (mobile) .

13. Një sistem kontrolli gramatikor, sistem që përmban: funksion kontrolli gramatikor në një mjet kompjuterik të integruar në një mjedis kompjuterik, për të analizuar tekstin e nxjerrë nga një mjet kompjuterik i dytë i shkëputur, për të parë gabimet gramatikore, ku mjeti i dytë kompjuterik ia transmeton tekstin funksionit të kontrollit gramatikor nëpërmjet një rrjeti komunikimesh, dhe funksioni i kontrollit gramatikor zbulon në mënyrë automatike një numër gabimesh të mundshme gramatikore në tekst nëpërmjet algoritmeve të programimit kompjuterik, e kategorizon secilin prej numrit të kapur të gabimeve të mundshme si një prej së paku gabim i mundshëm gramatikor me siguri të lartë dhe një gabim i mundshëm me siguri të ulët, ku gabim i mundshëm me siguri të lartë konsiderohet gabimi i identifikuar dhe gabim i mundshëm me siguri të ulët është gabimi të cilin funksioni i kontrollit gramatikor nuk mund ta përcaktojë dot nëse ekziston me siguri mjaftueshëm të lartë, dhe dërgon automatikisht drejt secilit prej numrit të mjeteve kompjuterike të redaktorëve përdorues në një popullsi burimesh, së paku një pjesë përkatëse të tekstit që përmban së paku një prej numrit të gabimeve të mundshme gramatikore të kategorizuara si gabim i mundshëm me siguri të ulët në mënyrë që të kryhet një proces i përbashkët më i gjerë për kapjen e gabimit në pjesën e tekstit nga një numër redaktorësh paralelisht për ato gabime gramatikore të kategorizuara si gabime të mundshme me siguri të ulët, për të përcaktuar nëse ka me të vërtetë gabim, ku gabimi i

përcaktuar nga redaktori (specialist i gjuhës shqipe) që është gabim me të vërtetë mund të korrigjohet nga redaktori përdorues për të nxjerrë rezultatin e korrigjimit ose i dërgohet sërish funksionit të kontrollit gramatikor për korrigjim automatik ose për shpërndarje si gabim i identifikuar të së paku një prej redaktorëve (specialist të gjuhës shqipe), ku funksioni i kontrollit gramatikor menaxhon shpërndarjen automatike të së paku disa prej gabimeve të identifikuara të numrit të përdoruesve, në mënyrë që korrigjimi njerëzor gramatikor i zgjeruar të kryhet paralelisht në mënyrë të përbashkët nga numri i redaktorëve për të nxjerrë rezultatet e korrigjimit, ku secili prej numrit të redaktorëve lidhet me një renditje cilësore dhe merr së paku një pjesë përgjegjëse të tekstit që përmban gabim të identifikuar bazuar në renditjen cilësore që i është caktuar, dhe ku secili prej mjeteve kompjuterike të përdoruesve është i veçuar nga mjeti i parë kompjuterik dhe mjeti i dytë kompjuterik, ku rezultatet e korrigjimit të kontrollit gramatikor të zgjeruar nga përdoruesi nga numri i redaktorëve merren nga funksioni i kontrollit gramatikor dhe përfshihen në mënyrë automatike me çfarëdo pjese teksti të korrigjuar në mënyrë automatike të funksionit të kontrollit gramatikor për të kontribuar në një version të korrigjuar të tekstit të marrë, dhe ku së paku një version i korrigjuar i dërgohet sërish mjetit të dytë kompjuterik.

14. Sistemi i pretendimit të 13-të, ku mjeti i dytë kompjuterik është server (enterprise server).

15. Sistemi i pretendimit të 14-të, ku serveri (enterprise server) mban një shërbim të aksuesueshëm në rrjet të funksionit të kontrollit gramatikor, ku mjeti i dytë kompjuterik ia transmeton tekstin funksionit të kontrollit gramatikor nëpërmjet një ndërfaqjeje programimi me aplikacion.

16. Sistemi i pretendimit të 13-të, ku ndërfaqja programuese me aplikacion lidhet me së paku një prej aplikacioneve të palës së tretë, përpunues fjalësh, një faqe kërkimi në internet, motorr kërkimi, klient poste elektronike, aplikacion mesazhesh, aplikacion blogu, aplikacion mikro-blogu, funksion të menaxhimit të përmbajtjes, funksion publikimi/botimi dhe funksion reklamimi.

17. Një metodë kontrolli gramatikor, metodë e cila përmban: marrjen e teksteve nëpërmjet rrjetit të komunikimeve prej funksionit të kontrollit gramatikor të vendosur në një pajisje kompjuterike nga një mjet i dytë kompjuterik, ku funksioni i kontrollit gramatikor zbulon në mënyrë automatike një numër gabimesh të mundshme gramatikore në tekst nëpërmjet algoritmeve të programit kompjuterik, kategorizon secilin prej gabimeve gramatikore të numrit të zbuluar të gabimeve të mundshme gramatikore si një, së paku, gabim i mundshëm me siguri të lartë dhe një gabim i mundshëm me siguri të ulët, ku gabim i mundshëm me siguri të lartë konsiderohet gabimi i identifikuar dhe gabim i mundshëm me siguri të ulët si një që funksioni i kontrollit gramatikor nuk mund ta përcaktojë ekzistues me siguri mjaftueshëm të lartë; transmetimin në mënyrë automatike të secilit prej numrit të gabimeve të mundshme gramatikore të kategorizuara si gabime me siguri të ulët nga funksioni i kontrollit gramatikor nëpërmjet rrjetit të komunikimeve drejt një numri mjeteve kompjuterike të përdoruesve të një numri redaktorësh në një popullsi burimesh, ku gabimet gramatikore të kategorizuara si gabime me siguri të ulët shpërndahen paralelisht me numrit të mjeteve kompjuterike të përdoruesve, ku secili prej numrit të gabimeve të mundshme gramatikore kategorizuar si gabim me siguri të ulët i transmetohet së paku njërit prej numrit të mjeteve kompjuterike të redaktorëve për identifikimin e gabimit, ku funksioni i kontrollit gramatikor nuk mund ta përcaktonte nëse kishte gabim apo jo me siguri mjaftueshëm të lartë, ku së paku një prej gabimeve të mundshme gramatikore kategorizuar si gabime me siguri të ulët transmetohet në së paku dy redaktorë nga numri i redaktorëve (specialistë të gjuhës shqipe) për vlerësim, ku një prej së paku dy redaktorëve kryen identifikimin e gabimit dhe një prej së paku dy prej redaktorëve kryen korrigjimin e gabimit, ku gabimet e identifikuara korrigjohen nga së paku një prej funksioneve të kontrollit gramatikor për të nxjerrë pjesët e korrigjuara të tekstit dhe së paku një prej numrit të redaktorëve të nxjerrë rezultatet e korrigjimit, dhe ku secili prej mjeteve

kompjuterike të redaktorëve është i veçuar nga mjeti i parë kompjuterik dhe mjeti i dytë kompjuterik; marrjen, nga funksioni i kontrollit gramatikor, e çfarëdo rezultati korrigjimi nga numri i redaktorëve dhe përfshirjen e çfarëdo rezultati korrigjimi nga numri i redaktorëve në cilëndo pjesë teksti të korrigjuar të funksionit të kontrollit gramatikor për të kontribuar në versionin e korrigjuar të tekstit, ku secili prej numrit të redaktorëve lidhet me një renditje cilësie të kontrollit gramatikor, dhe nëse vlerësimi rezultues i së paku dy redaktorëve nuk përputhet, atëherë versioni i korrigjuar i tekstit përfshin vlerësimin e redaktorit që ka renditjen më të lartë; dhe transmetimin e tekstit të korrigjuar të mbledhur drejt mjetit të dytë kompjuterik.

18. Metoda e pretendimit të 17-të, që përfshin më tej zbulimin, nga numri i redaktorëve (specialistë të gjuhës shqipe) , e gabimeve të tjera gramatikore që nuk janë gjetur në zbulimin automatik të funksionit të kontrollit gramatikor në numrin e gabimeve të mundshme gramatikore, dhe korrigjimin, nga numri i redaktorëve, e gabimeve të tjera gramatikore përveç korrigjimit të numrit të gabimeve gramatikore të kategorizuara si gabime të mundshme me siguri të ulët të zbuluara nga funksioni i kontrollit gramatikor.

19. Metoda e pretendimit të 17-të, ku së paku një prej numrit të mjeteve kompjuterike të redaktorëve është mjet kompjuterik i lëvizshëm (mobile) .

20. Metoda e pretendimit të 17-të, ku një përdorues i mjetit të dytë kompjuterik ka vendosur më parë tekstin e marrë në mjetin e dytë kompjuterik.

21. Metoda e pretendimit të 20-të, ku përdoruesi i mjetit të dytë kompjuterik ka vendosur tekstin e marrë nëpërmjet së paku një prej veprimeve të drejtpërdrejta si shtypjes, ngarkimit dhe kopjimit dhe ngjitjes në një aplikacion në mjetin e dytë kompjuterik.

22. Metoda e pretendimit të 20-të, ku përdoruesi ka vendosur tekstin e marrë nëpërmjet një ndërfaqjeje programimi me aplikacion (API) të lidhur me funksionin e kontrollit gramatikor.

23. Metoda e pretendimit të 17-të, që përmban më tej kontrollin gramatikor të tekstit të korrigjuar të mbledhur përpara transmetimit të tekstit të korrigjuar të mbledhur në mjetin e dytë kompjuterik.

24. Metoda e pretendimit të 23-të, ku kontrolli gramatikor i tekstit të korrigjuar të mbledhur bëhet së paku pjesërisht nga funksioni i kontrollit gramatikor.

25. Metoda e pretendimit të 23-të, ku kontrolli gramatikor i tekstit të korrigjuar të mbledhur bëhet së paku pjesërisht nga numri i redaktorëve (specialistë të gjuhës shqipe) .

26. Metoda e pretendimit të 23-të, ku numri i redaktorëve (specialistë të gjuhës shqipe) monitorohet mbi cilësinë e redaktimit, për të përditësuar renditjen përkatëse të redaktorëve.

27. Metoda e pretendimit të 26-të, ku cilësia e përcaktuar e redaktimit për një redaktor përcakton llojin e gabimit të zbuluar që i transmetohet në vijim redaktorit.

(22) 05.05.2023

(21) [AL/P/2023/183](#)

(54) MOTORRET DHE AGREGARET ME VETEFURNIZIM

(71) LUAN HOXHA /Rr "Besmir Azemi", Veternik, 10000, Prishtine, KS.

(72) LUAN HOXHA /Rr "Besmir Azemi", Veternik, 10000, Prishtine, KS.

(55)




Figure 1




Figure 10




Figura 11




Figura 12




Figura 13






Figura 14





a)



b)








Figure 2






Figura 2




Figura 4




Figura 5

(57)1. Motorët dhe agregatët me vet furnizim karakterizohen nga karakteristika e tyre që pas fillimit në punë të makinave me vet furnizim të cilat janë prezentuar siq janë motorët dhe agregatët, për tu vet furnizuar me energji të nevojshme për të punuar, dhe energjinë tjetër të prodhuar gjatë punës së tyre jua mundëson fuqizuesi mekanik(10) i cili e rritë forcën në dalje për shumë herë nga forca që ka vepruar në hyrje dhe forcën e rritur e bartë në dalje(12) të tij. Kjo forcë e rritur nga fuqizuesi mekanik(10) përdoret për të prodhuar energjinë, një pjesë e së cilës shfrytëzohet për ti plotësuar nevojat e vet makinës për të punuar dhe pjesa tjetër e energjisë e cila është prodhuar shfrytëzohet për ti furnizuar shpenzuesit e tjerë në vendin ku përdoren këto makina figurat(1,2,3,4,5,6,7,8,9,10, 11,12,13,14) .

2. Për të filluar për të punuar makinat me vet furnizim përdorin energjinë elektrike të rezervuar në baterinë(8) figura(1,2,5,6,9,10,11,12,13,14) , energjinë potenciale të gazit të ngjeshur në rezervuarin e gazit(16) figurat(3,7) , energjinë potenciale të lëngut në rezervuarin e lëngut(40)

figura(4,8) .

3. Karakteristika e cila i karakterizon motorët me vet furnizim me energji elektrike figura (1,2) se për aktivizim dhe mbajtje në punë përdoret energjia elektrike e rezervuar në baterinë(8) të cilën e përdorë për punë elektromotori(9) figura 1 ose elektromagneti(65) figura 2. Elektromotori(9) figura 1 vepron me forcë në hyrje(18) të fuqizuesit mekanik(10) ose elektromagneti(65) figura 2 vepron me forcë në hyrje(12) të fuqizuesit mekanik(10) pastaj këtë forcë që ka vepruar në hyrje në fuqizuesit mekanik(10) , fuqizuesi mekanik(10) e rritë për disa herë në raport me forcën që ka vepruar në hyrje dhe ashtu të rritur e bartë në daljen(12) të tij(pretendimi i pavarur 1) . Kur veprohet me forcë në hyrje të fuqizuesit mekanik(10) dalja(12) e fuqizuesit mekanik(10) zhvendosët poshtë lartë dhe lartë poshtë, pastaj kjo forcë e rritur përdoret për prodhimin e energjisë një pjesë e kësaj energjie të prodhuar shfrytëzohet për plotësimin e nevojave të punës së vet motorëve për të punuar, dhe pjesa tjetër e energjisë së mbetur shfrytëzohet për shpenzues të tjerë në vendet ku përdorën këta motor.

Në daljen(12) të fuqizuesit mekanik(10) është vendosur boshti(11) i parë, pastaj në boshtin(11) të parë është vendosur kushineta(4) e parë, dhe në kushinetën(4) të parë vendoset skaji i parë i krahut(3) , në skajin e parë të krahut(3) vendoset buloni(43) deri në perimetrin e kushinetës(4) të parë me qëllim të përforcimit të skajit të parë të krahut(3) për kushinetën(4) të parë, pastaj në boshtin(11) të parë pas vendosjes së skajit të parë të krahut(3) në kushinetën(4) të parë vendoset siguresa(14) e parë në boshtin(11) të parë për ta mbajtur në boshtin(11) të parë kushinetën(4) të parë sëbashku me skajin e parë të krahut(3) .

Boshti(11) i dytë është i vendosur në rrotën(5) në pozitë i larguar për një distacë prej qendrës së rrotës(5) , kushineta(4) e dytë është vendosur në boshtin(11) të dytë, skaji i dytë i krahut(3) është vendosur në kushinetën(4) të dytë, pas vendosjes së skajit të dytë të krahut(3) në kushinetën(4) të dytë në boshtin(11) të dytë vendoset në skajin e dytë të krahut(3) buloni(43) i dytë deri në perimetrin e kushinetës(4) të dytë për ta përforcuar skajin e dytë të krahut të dytë për kushinetën(4) të dytë, pastaj vendoset siguresa(14) e dytë në boshtin(11) të dytë për ta mbajtur në boshtin(11) të dytë kushinetën(4) të dytë dhe rrotën(5) . Boshti (11) i tretë është vendosur në shtyllën(2) dhe i përforcuar me dadon(56) të parë dhe me dadon(56) të dytë për shtyllën(2) . Pas vendosjes së boshtit(11) të tretë në shtyllën(2) vendoset buloni(43) i katërtë në boshtin(11) të tretë për ta mbajtur kushinetën(4) të tretë në pozitë të caktuar gjatë rrotullimit të kushinetës(4) të tretë rreth boshtit(11) të tretë, pastaj vendoset kushineta(4) e tretë në boshtin(11) të tretë, pas vendosjes së kushinetës(4) të tretë në boshtin(11) të tretë vendoset rrota(5) në kushinetën(4) të tretë, pas vendosjes së rrotës(5) në kushinetën(4) të tretë vendoset buloni(43) i katërt. Buloni(43) i tretë e përforcon rrotën(5) për kushinetën(4) të tretë në pjesën e rrotës(5) e cila është pak e dalur nga rrota(5) , pastaj pas vendosjes së rrotës(5) në kushinetën(4) të tretë është vendosur dado(56) e tretë në boshtin(11) të tretë për ta mbajtur kushinetën(4) të tretë në boshtin(11) të tretë në pozicion të caktuar, pastaj vendoset siguresa(14) e tretë në boshtin(11) të tretë për ta mbajtur dadon(56) të tretë dhe rrotën(5) në pozicion të caktuar. Në shtyllën(2) në pozitë më lartë se perimetri i rrotës(5) është vendosur dhe përforcuar me bulona(43) pllaka(57) me kushinetën(59) me bulona(58) e cila nuk shifet prej rrotës(37) , në kushinetën(59) është vendosur boshti(11) i katërt pas vendosjes së boshtit(11) të katërt në kushinetën(59) përforcohet boshti(11) i katërt me bulonat(58) të cilët gjenden në kushinetën(59) , pas vendosjes së rrotës(37) në boshtin(11) të katërt, rrota(37) përforcohet për boshtin(11) të katërt me bulonin(43) të katërt në pjesën e cila është pak e dalur nga rrota(37) , pastaj vendoset dado(56) e katërtë në boshtin(11) të katërtë për ta mbajtur rrotën(37) në boshtin(11) të katërt, pas vendosjes së dados(56) në boshtin(11) të katërt vendoset siguresa(14) e katërt në boshtin(11) të katërt për ta mbajtur dadon(56) të katërt në boshtin(11) të katërt. Në rrotën(5) dhe

në rrotën e cila është e vendosur në boshtin e gjeneratorin(7) është vendosur rripi(6) i parë, në rrotën(5) dhe në rrotën(37) është vendosur rripi(6) i dytë.

Bartja e forcës nga dalja(12) e fuqizuesit mekanik(10) bëhet në këtë mënyrë: kur fillon të zhvendoset lartë poshtë dhe poshtë lartë dalja(12) e fuqizuesit mekanik(10) sëbashku me daljen(12) të fuqizuesit mekanik(10) zhvendoset edhe boshti(11) i parë i cili është i vendosur në daljen(12) të fuqizuesit mekanik(10), nga boshti(11) i parë gjatë zhvendosjes poshtë lartë dhe lartë poshtë bartet forca në krahun(3) dhe nga krahu(3) në rrotën(5). Kjo forcë e bartur në rrotën(5) përdoret për të prodhuar energji. Energjia e prodhuar shfrytëzohet për prodhimin e energjisë elektrike nga gjeneratori(7) e cila shfrytëzohet për punë të vet motorit dhe pjesa tjetër e energjisë së prodhuar bartet në boshtin(11) të katërt për tu përdorur nga shpenzues të tjerë.

Gjatë zhvendosjes poshtë lartë dhe lartë poshtë dalja(12) e fuqizuesit mekanik(10) lëviz edhe boshti(11) i parë, boshti(11) i parë sëbashku me kushinetën(4) të parë të vendosur në të lëvizin poshtë lartë dhe lartë poshtë. Gjatë lëvizjes nga poshtë lartë boshti(11) i parë sëbashku me kushinetën(4) të parë e shtynë skajin e parë të krahut(3), krahu(3) është në pozitë të pjerrët gjatë shtyrjes nga boshti(11) i parë i skajit të parë të krahut(3) lëviz i gjithë krahu(3) në kahjen e shtyrjes, skaji i dytë i krahut(3) lëviz sëbashku me kushinetën(4) të dytë dhe e shtyen boshtin(11) të dytë i cili është i vendosur në rrotën(5) i larguar për një distancë prej qendrës së rrotës(5), boshti(11) i dytë e shtyen rrotën(5), por rrota(5) nuk bënë lëvizje translativë sepse nuk e lejon boshti(11) i tretë i cili është i përforcuar për shtyllën(2) por bënë lëvizje rrotulluese sëbashku me kushinetën(4) të tretë në boshtin(11) të tretë, dalja(12) kur të lëviz poshtë lartë e shtyen boshtin(11) të parë, dhe kur të lëviz nga lartë poshtë e tërheq skajin e parë të krahut(3) të parë boshti(11) i parë, me tërheqjen e skajit të parë të krahut(3) teposhtë tërheqet i gjithë krahu(3) teposhtë, sepse boshtin(11) të parë e tërheq dalja(12) e fuqizuesit mekanik(10) teposhtë. Ky cikël i shtyrjes dhe i tërheqjes së krahut(3) poshtë lartë dhe lartë poshtë duhet të përsëritet për të punuar motori në vazhdimësi.

Në rrotën(5) ka dy vende për vendosjen e rripiave(6), rripi(6) i parë vendoset në rrotën(5) dhe në rrotën e cila është e vendosur në boshtin e rotorit të gjeneratorit(7) të rrymës së vazhduar, ndërsa rripi(6) i dytë është i vendosur në rrotën(5) dhe në rrotën(37). Kur të rrotullohet rrota(5) i fut në lëvizje rripin(6) të parë dhe rripin(6) të dytë, rripi(6) i parë gjatë lëvizjes e rrotullon rrotën e cila e rrotullon boshtin e rotorit të gjeneratorit(7), rripi(6) i dytë gjatë lëvizjes e rrotullon rrotën(37). Gjeneratori(7) rrotullimin e boshtit të rotorit të vet e shfrytëzon për prodhimin e energjisë elektrike, me të cilën furnizohet bateria(8), rrota(37) gjatë rrotullimit e rrotullon edhe boshtin(11) të katërt, në boshtin(11) të katërt mund të lidhen shpenzues të tjerë për ta shfrytëzuar pjesën e energjisë së prodhuar të motorit e cila nuk shfrytëzohet për nevojat të punës së vet motorit.

4. Karakteristika e cila i karakterizon motorin me vet furnizim me gaz figura 3 është se aktivizon dhe e mbanë në punë gazi i ngjeshur në rezervuarin e gazit(16) të cilën e përdorë për punë turbina e gazit(19). Pas hapjes së ventilin të gazit(15) fillon të rrjedhë gazi i ngjeshur nga rezervuari i gazit(16) në gypin e gazit(18) të parë. Turbina e gazit(19) e shfrytëzon rrjedhjen e gazit të ngjeshur i cili kalon nëpër ventilin e gazit(15) nëpër gypin e gazit(18) të dytë dhe përmes portës(48) hynë në turbinën e gazit(19) dhe e rrotullon turbinën e gazit(19). Gazi që futet në turbinën e gazit(19) për ta rrotulluar turbinën del në atmosferë përmes portës së shkarkimit(39) të turbinës së gazit(19). Gjatë rrotullimit turbina(19) e rrotullon edhe boshtin në të cilin është vendosur, ky bosht pastaj vepron me forcë në hyrjen(18) të fuqizuesit mekanik(10), pastaj këtë forcë që ka vepruar në hyrje të fuqizuesit mekanik(10), fuqizuesi mekanik(10) e rritë për disa herë në raport me forcën që ka vepruar në hyrje dhe ashtu të rritur e bartë në daljen(12) të tij (pretendimi i pavarur 1) të cilën e zhvendosë poshtë lartë dhe lartë poshtë.

Dalja(12) e fuqizuesit mekanik(10) zhvendoset poshtë lartë dhe lartë poshtë pastaj kjo forcë e

rritur përdoret për prodhimin e energjisë një pjesë e kësaj energjie të prodhuar shfrytëzohet për plotësimin e nevojave të punës së vet motorit dhe pjesa tjetër e energjisë së mbetur shfrytëzohet nga shpenzues të tjerë në vendet ku përdoret ky motor.

Në daljen(12) të fuqizuesit mekanik(10) bëhet lidhja e njejtë sikur në pretendimin e varur 1 por ndryshon vetëm te vendosja e rripit(6) të parë i cili vendoset në rrotën e cila është e vendosur në boshtin e kompresorit të gazit(17).

Bartja e forcës nga dalja(12) e fuqizuesit mekanik(10) bëhet në këtë mënyrë: kur fillon të zhvendoset lartë poshtë dhe poshtë lartë dalja(12) e fuqizuesit mekanik(10) sëbashku me daljen(12) të fuqizuesit mekanik(10) zhvendoset edhe boshti(11) i parë i cili është i vendosur në daljen(12) të fuqizuesit mekanik(10), nga boshti(11) i parë gjatë zhvendosjes poshtë lartë dhe lartë poshtë bartet forca në rrotën(5) e cila përdoret për të prodhuar energji mekanike. Energjia e prodhuar shfrytëzohet për punën e kompresorit të gazit(17) i cili e mbush rezervuarin e gazit(16) me gaz nga atmosfera i cili shfrytëzohet për punë të vet motorit dhe pjesa tjetër e energjisë bartet në boshtin(11) të katërt për tu përdorur nga shpenzues të tjerë.

Në rrotën(5) ka dy vende për vendosjen e rripiave(6), rripi(6) i parë vendoset në rrotën(5) dhe në rrotën e cila është e vendosur në boshtin rrotullues të kompresorit të gazit(17), ndërsa rripi(6) i dytë është i vendosur në rrotën(5) dhe në rrotën(37). Kur të rrotullohet rrota(5) i fut në lëvizje rripin(6) të parë dhe rripin(6) të dytë, rripi(6) i parë gjatë lëvizjes e rrotullon rrotën e cila e rrotullon boshtin e kompresorit të gazit(17), rripi(6) i dytë gjatë lëvizjes e rrotullon rrotën(37).

Kompresori i gazit(17) rrotullimin e boshtit të vet e shfrytëzon për ulëjen e pistonit teposhtë për të marrë gaz nga atmosfera gjatë uljes së pistonit teposhtë të kompresorit të gazit(17) filtrohet gazi nga filteri i gazit(60) hapet ventili jo kthyes i gazit(38) të parë dhe e lejon të hyjë gazi nga atmosfera për në piston, dhe ngritjen e pistonit përpjetë për të dërguar gazin e marrur nga atmosfera për në rezervuarin e gazit(16). Gjatë ngritjes përpjetë të pistonit gazin që gjendet në vëllim të pistonit nuk e lejon të dalë në atmosferë kur ngritet pistonin përpjetë ventili jo kthyes(38) i parë, por kalon nga kompresori i gazit(17) në gypin e gazit(18) të tretë përmes portës(49), nga gypi i gazit(18) të tretë kalon në ventilin jo kthyes të dytë të gazit(38), nga ventili i gazit jo kthyes(38) të dytë kalon në gypin e gazit(18) të katërtë, dhe nga gypi i gazit(18) të katërtë kalon në rezervuarin e gazit(16), pastaj me gazin e rezervuar në rezervuarin e gazit(16) furnizohet turbina e gazit(19), rrota(37) gjatë rrotullimit e rrotullon edhe boshtin(11) të katërt, në boshtin(11) të katërt mund të lidhen shpenzues të tjerë për ta shfrytëzuar pjesën e energjisë së prodhuar të motorit e cila nuk shfrytëzohet për nevojat të punës së vet motorit.

5. Karakteristika e cila i karakterizon motorin me vet furnizim me lëng figura 4 është se aktivizon dhe e mbanë në punë lëngu i cili është i rezervuar në rezervuarin(40) prej gome i cili shtyhet nga gazi i ngjeshur i cili gjendet ndërmjet mureve të brendshme të rezervuarit(22) si dhe mureve të jashtme të rezervuarit(40). Gazi i ngjeshur vepron në muret e jashtme të rezervuarit prej gome(40) i cili ndrydhë rezervuarin prej gome(40) dhe si rezultat i kësaj ndrydhëje e shtyen lëngun në rezervuarin prej gome(40). Lëvizja e lëngut nga rezervuari prej gome(40) përdoret për ta futur në lëvizje turbinën e lëngut(24).

Pas hapjes së ventilit të lëgut(23) fillon të rrjedhë lëngu nga rezervuari prej gome(40) i cili shtyhet nga gazi i ngjeshur i cili gjendet në rezervuarin(22). Ky lëng rrjedhë përmes portës(47) dhe kalon në gypin e lëgut(25) të parë pastaj në ventilin e lëgut(23) dhe nga ventili i lëgut(23) kalon në gypin e lëgut(25) të dytë dhe nga gypi i lëgut(25) të dytë përmes portës(45) futet në turbinën e lëgut(24), turbina e lëgut(24) e shfrytëzon këtë rrjedhje të lëgut për tu rrotulluar. Lëngu që futet në turbinën e lëgut(24) për ta rrotulluar turbinën del përmes portës(44) në gypin(25) të tretë dhe nga gypi(25) i tretë kalon në rezervuarin e lëgut(27). Gjatë rrotullimit turbina e lëgut(24) e

rrotullon edhe boshtin në të cilin është vendosur, ky bosht pastaj vepron me forcë në hyrjen(18) të fuqizuesit mekanik(10) , pastaj këtë forcë që ka vepruar në hyrje të fuqizuesit mekanik(10) , fuqizuesi mekanik(10) e rritë për disa herë në raport me forcën që ka vepruar në hyrjen(18) të tij dhe ashtu të rritur e bartë në daljen(12) të tij të cilën e zhvendosë poshtë lartë dhe lartë poshtë (pretendimi i pavarur 1) , forca e rritur në daljen(12) të fuqizuesit mekanik(10) përdoret për prodhimin e energjisë, një pjesë e kësaj energjie të prodhuar shfrytëzohet për plotësimin e nevojave të punës së vet motorit, dhe pjesa tjetër e energjisë së mbetur shfrytëzohet për shpenzues të tjerë në vendet ku shfrytëzohet ky motor.

Në daljen(12) të fuqizuesit mekanik(10) bëhet lidhja e njejtë sikur në pretendimin e varur 1 por ndryshon vetëm te vendosja e rripit(6) të parë i cili vendoset në rrotën e cila është e vendosur në boshtin e turbines së lëngut(28) .

Bartja e forcës nga dalja(12) e fuqizuesit mekanik(10) bëhet në këtë mënyrë: kur fillon të zhvendoset lartë poshtë dhe poshtë lartë dalja(12) e fuqizuesit mekanik(10) sëbashku me daljen(12) të fuqizuesit mekanik(10) zhvendoset edhe boshti(11) i parë i cili është i vendosur në daljen(12) të fuqizuesit mekanik(10) , nga boshti(11) i parë gjatë zhvendosjes poshtë lartë dhe lartë poshtë bartet forca në rrotën(5) e cila përdoret për të prodhuar energji. Një pjesë e energjisë së prodhuar në rrotën(5) shfrytëzohet për rrotullimin e turbinës së lëngut(28) e cila e merr lëngun nga gypi i lëngut(25) i katërt përmes portës(53) dhe e dërgon në gypin(25) të pestë përmes portës(54) , dhe nga gypi i lëngut(25) të pestë kalon në rezervuarin prej gome(40) , ku pastaj këtë lëng e shfrytëzon për punë të vet motorit dhe pjesa tjetër e energjisë së prodhuar në rrotën(5) bartët në boshtin(11) të katërt për tu përdorur nga shpenzues të tjerë në vendet ku përdoret motori.

Në rrotën(5) ka dy vende për vendosjen e rripiave(6) , rripi(6) i parë vendoset në rrotën(5) dhe në rrotën e cila është e vendosur në boshtin rrotullues të turbinës së lëngut(28) , ndërsa rripi(6) i dytë është i vendosur në rrotën(5) dhe në rrotën(37) . Kur të rrotullohet rrota(5) i fut në lëvizje rripin(6) të parë dhe rripin(6) të dytë, rripi(6) i parë gjatë lëvizjes e rrotullon rrotën e cila e rrotullon boshtin e turbinës së lëngut(28) , rripi(6) i dytë gjatë lëvizjes e rrotullon rrotën(37) .

Kur rrotullohet boshti në të cilin është vendosur turbina e lëngut(28) e rrotullon edhe turbinën e lëngut(28) gjatë rrotullimit turbina e lëngut e tërheq lëngun nga rezervuari(27) i cili kalon në ventilin jo kthyes të lëngut(26) , nga ventili jo kthyes i lëngut(26) lëngu kalon në gypin e lëngut(25) të katërt hynë përmes portës(53) në turbinën e lëngut(28) , nga turbina e lëngut(28) përmes portës(54) kalon në gypin e lëngut(25) të pestë dhe nga gypi i lëngut(25) i pestë kalon në rezervuarin e lëngut(40) , pastaj ky lëngë i rezervuar në rezervuarin(40) përdoret për ta futur në lëvizje turbinën e lëngut(24) për të vazhduar me punuar motori me vet furnizim me lëngë, rrota(37) gjatë rrotullimit e rrotullon edhe boshtin(11) të katërt, në boshtin(11) të katërt mund të lidhen shpenzues të tjerë për ta shfrytëzuar pjesën e energjisë së prodhuar të motorit e cila nuk shfrytëzohet për nevojat të punës së vet motorit.

6. Karakteristika e cila i karakterizon Agregatin me vet furnizim me elektricitet figura 5 me gjenerator të rrymës alternative me lëvizje rrotulluese pas kycjes nga ndërprerësi(21) e tërë forca e elektromotorit(9) që është furnizuar me energji elektrike nga bateria(8) vepron në hyrjen(18) të fuqizuesit mekanik(10) , pastaj forcën që ka vepruar në hyrje(18) të fuqizuesit mekanik(10) , fuqizuesi mekanik(10) e bartë në daljen(12) të tij por të rritur për disa herë, dhe si rezultat i kësaj force dalja(12) e fuqizuesit mekanik(10) lëviz nga poshtë lartë dhe nga lartë poshtë.

Agregati me vet furnizim me elektricitet figura 6 me gjenerator të rrymës alternative me lëvizje rrotulluese pas kycjes nga ndërprerësi(21) e tërë forca elektromagnetike e elektromagnetit(9) që është furnizuar me energji elektrike nga bateria(8) vepron në elektromagnetin(13) të fuqizuesit mekanik(10) pastaj forcën që ka vepruar në elektromagnetin(13) të fuqizuesit mekanik(10) ,

fuqizuesi mekanik(10) e bartë në daljen(12) të tij por të rritur për disa herë, dhe si rezultat i kësaj force dalja(12) e fuqizuesit mekanik(10) lëviz nga poshtë lartë dhe nga lartë poshtë.

Në daljen(12) të fuqizuesit mekanik(10) bëhet lidhja e njejtë sikur në pretendimin e varur 1 por ndryshon se e tërë energjia e prodhuar shfrytëzohet nga gjeneratori(7) për prodhimin e energjisë elektrike.

Kur të rrotullohet rrota(5) e fut në lëvizje rripin(6) , rripi(6) gjatë lëvizjes e rrotullon rrotën e vendosur në boshtin e rotorit të gjeneratorit(7) . Gjatë rrotullimit të rrotës e cila është e vendosur në boshtin e rotorit të gjeneratorit(7) e rrotullon edhe boshtin e rotorit të gjeneratorit(7) , gjeneratori(7) pastaj rrotullimin e rotorit e shfrytëzon për prodhimin e energjisë elektrike.

Një pjesë e rrymës alternative e prodhuar nga gjeneratorit(7) kthehet në rrymë elektrike të vazhduar nga konvertori(29) në kabllon(20) për ta furnizuar baterinë(8) me rrymë elektrike e cila pastaj përdoret për furnizimin e elektromotorit(9) figura(5) ose elektromagnetit(65) figura(6) , pjesa tjetër e rrymës alternative e prodhuar nga gjeneratori(7) bartët në kabllon(13) për tu shpenzuar nga shpenzues të tjerë.

7. Karakteristika e cila e karakterizon agregatin me vet furnizim me gaz figura 7 e shfrytëzon energjinë e prodhuar nga motori me vet furnizim me gaz figura 3 të cilën nuk e përdor për punën e vet motori me vet furnizim me gaz figura 2 për ta rrotulluar rotorin e gjeneratorin(7) të vendosur në shtyllën(2) për të prodhuar energji elektrike.

8. Karakteristika e cila e karakterizon agregatin me vet furnizim me lëng figura 8 e shfrytëzon energjinë e prodhuar nga motori me vet furnizim me lëng figura 4 të cilën nuk e përdor motorin me vet furnizim me lëng figura 4 për punën e vet për ta rrotulluar rotorin e gjeneratorin(7) të vendosur në shtyllën(2) për të prodhuar energji elektrike.

9. Karakteristika e cila e karakterizon agregatin me vet furnizim me elektricitet me gjenerator të rrymës alternative me zhvendosje translativë (AL/P/2016/296) figura(9) dhe figura(10) ndryshojnë vetëm se në figurën(9) përdoret elektromotori(9) , ndërsa në figurën(10) përdoret elektromagnetit(56) në hyrje të fuqizuesit mekanik(10) të tjerat janë të njëjta. Agregati me vet furnizim me elektricitet me gjenerator të rrymës alternative me zhvendosje translativë (AL/P/2016/296) figura(9) pas kyçjes nga ndërprerësi(21) e tërë forca e elektromotorit(9) që është furnizuar me energji elektrike nga bateria(8) vepron në hyrje të fuqizuesit mekanik(10) , pastaj forcën që ka vepruar në hyrje të fuqizuesit mekanik(10) , fuqizuesi mekanik(10) e bartë në daljen(12) të tij por të rritur për disa herë, dhe si rezultat i kësaj force dalja(12) e fuqizuesit mekanik(10) lëviz nga poshtë lartë dhe nga lartë poshtë.

Agregati me vet furnizim me elektricitet me gjenerator të rrymës alternative me zhvendosje translativë(AL/P/2016/296) figura(10) pas kyçjes nga ndërprerësi(21) e tërë forca e elektromagnetit(65) që është furnizuar me impulse elektrike nga rregullatori i impulseve elektrike(66) i cili furnizohet me energji elektrike nga bateria(8) vepron në hyrje të fuqizuesit mekanik(10) , pastaj forcën që ka vepruar në hyrje të fuqizuesit mekanik(10) , fuqizuesi mekanik(10) e bartë në daljen(12) të tij por të rritur për disa herë, dhe si rezultat i kësaj force dalja(12) e fuqizuesit mekanik(10) lëviz nga poshtë lartë dhe nga lartë poshtë.

Në daljen(12) të fuqizuesit mekanik(10) është vendosur shtylla vertikale e profili($\perp$) (34) , nën sipërfaqën e shtyllës horizontale të profili($\perp$) (34) gjenden rrotat(36) të llozeve(33) të parë dhe të dytë. Kur zhvendoset lartë poshtë dhe poshtë lartë dalja(12) e fuqizuesit mekanik(10) sëbashku me të zhvendoset edhe profili ($\perp$) (34) . Gjatë zhvendosjes së profilin($\perp$) (34) teposhtë takohen sipërfaqet e rrotave(36) të llozeve(33) me sipërfaqen e shtyllës horizontale të profilin($\perp$) (34) i cili gjatë zhvendosjes teposhtë i zhvendosë teposhtë edhe rrotat(36) të llozeve(33) duke e bartur forcën nga profili($\perp$) (34) në rrotat(36) . Gjatë zhvendosjes teposhtë rrotat(36) lëvizin përgjatë sipërfaqës

së profilin($\perp$) (34) por i zhvendosin teposhtë edhe krahët e forcës së llozeve(33) në kahjen e zhvendosjes së vet dhe e bartët forca nga rrotat(36) në krahët e forcës së llozeve(33) . Kur zhvendosen teposhtë krahët e forcës së llozeve(33) zhvendosen teposhtë edhe krahët e barrës së llozeve(33) ku bartët forca nga krahët e forcës së llozeve(33) në krahët e barrës së llozeve(33) nga krahët e barrës së llozeve(33) forca bartët në shtyllat(32) duke i zhvendosur edhe shtyllat(32) teposhtë, kur zhvendosën shtyllat(32) teposhtë zhvendoset edhe pjesa në gjeneratorin(30) e cila bënë lëvizje translative nga lartë poshtë kur veprohet me forcë mbi të, dhe nga poshtë lartë lëviz kur i ndërprehet forca që e ka zhvendosur teposht dhe nuk e mbanë poshtë përmes mekanizmit të kthimit të cilin e kanë gjeneratorët(30) (AL/P/2016/296 figura(2,3,4,5,6,7,8,9) . Zhvendosja e pjesës e cila zhvendoset kur veprohet me force mbi të në gjeneratorin(30) prodhon rrymë elektrike gjatë zhvendosjes nga lartë poshtë, por edhe kur zhvendoset nga poshtë lartë. Pas zhvendosjes teposhtë dalja(12) e fuqizuesit mekanik(10) , pastaj fillon të zhvendoset përpjetë, gjatë zhvendosjes përpjetë e zhvendosë përpjetë edhe profilin($\perp$) (34) . Kur ta zhvendosë përpjetë profilin($\perp$) (34) ndërprehet forca e cila i ka zhvendosur krahët e forcës së llozeve(33) teposhtë por që nuk i mbanë në pozitën poshtë, pas ndërprerjes së forcës e cila i ka zhvendosur teposhtë krahët e forcës së llozeve(33) vepron pjesa e cila u zhvendos e gjeneratorëve(33) për tu kthyer në gjendje e marshme para zhvendosjes përmes mekanizmit të kthimit të cilët janë në gjeneratorët(30) (shpikja AL/P/2016/296) figura(2,3,4,5,6,7,8,9) . Gjatë kthimit të pjesës e cila zhvendoset në gjeneratorët(30) përpjetë kjo pjesë i shtynë përpjetë edhe shtyllat(32) , pastaj shtyllat(32) i shtynë përpjetë krahët e forcës dhe krahët e barrës së llozeve(33) përpjetë. Gjatë kthimit përpjetë të pjesës e cila është zhvendosur poshtë e gjeneratorëve(30) prodhohet energji elektrike. Energjia e prodhuar nga gjeneratorët(30) bartët në kabëllën(13) . Për të prodhuar energji elektrike në vazhdimësi duhet të përsëritet cikli i zhvendosjes së pjesës që zhvendoset në gjeneratorë(30) lartë poshtë dhe poshtë lartë. Pas prodhimit të energjisë elektrike nga gjeneratorët(30) një pjesë e kësaj energjie elektrike kthehet në rrymë të vazhduar nga konvertori(29) i cili rrymën antenative e merr nga kabllo(20) e parë e cila është e lidhur për kabllon(13) dhe e kthen rrymën elektrike alternative në rrymë elektrike të vazhduar e cila pasataj përmes kablllos(20) të dytë dërgohet në baterinë(8) për tu rezervuar, kjo energji elektrike e rezervuar pastaj shfrytëzohet për ta furnizuar me energji elektrike elektromotorin(9) figura(9) ose elektromagnetin(65) figura(10) për të punuar, dhe pjesa tjetër e mbetur e energjisë elektrike e prodhuar nga gjeneratorët(30) përdoret për në shpenzues të tjerë.

10. Në agregatin me vet furnizim me elektricitet figura(9,10) pretendimi i varur 6 mund të përdoret vetm një gjenerator(30) , por edhe më shumë se dy gjenerator(30) me zhvendosje translative njëkohësisht për prodhimin e energjisë elektrike.

11. Në agregatin me vet furnizim me energji elektrike përdoret fuqia e elektromotorit(9) në hyrje të fuqizuesit mekanik(10) dhe zhvendosja e magnetit(68) nga dalja(12) e fuqizuesit mekanik(10) për tu prerë vijat e fushës magnetike të magnetit(68) nga dredhat prej teli të bobinës(67) për tu induktuar rrymë elektrike alternative në bobinën(67) figura11; në agregatin me vet furnizim me energji elektrike përdoret forca elektromagnetike e elektromagnetit(65) në hyrje të fuqizuesit mekanik(10) dhe zhvendosja e magnetit(68) nga dalja(12) e fuqizuesit mekanik(10) për tu prerë vijat e fushës magnetike të magnetit(68) nga dredhat prej teli të bobinës(67) për tu induktuar rrymë elektrike alternative në bobinën(67) figura12; në agregatin me vet furnizim me energji elektrike përdoret fuqia e elektromotorit(9) në hyrje të fuqizuesit mekanik(10) dhe zhvendosja e bobinës(67) nga dalja(12) e fuqizuesit mekanik(10) për tu prerë vijat e fushës magnetike të magnetit(68) nga dredhat prej teli të bobinës(67) për tu induktuar rrymë elektrike alternative në bobinën(67) figura13; në agregatin me vet furnizim me energji elektrike përdoret forca elektromagnetike e elektromagnetit(65) në hyrje të fuqizuesit mekanik(10) dhe

zhvendosja e bobinës(67) nga dalja(12) e fuqizuesit mekanik(10) për tu prerë vijat e fushës magnetike të magnetit(68) nga dredhat prej teli të bobinës(67) për tu induktuar rrymë elektrike alternative në bobinën(67) figura14. Agregatin me vet furnizim me energji elektrike karakterizohet nga karakteristika se një pjesë e rrymës alternative e induktuar në bobinën(67) të bartur në kabëllën(13) kthehet në rrymë elektrike të vazhduar për ti plotësuar shpenzimet e energjisë elektrike që e shpenzojnë elektromotori(9) në figurat(11,13), dhe elektromagneti(65) në figurat(12,14) që e shpenzojnë agregatët për punën e tyre dhe pjesa tjetër e energjisë së mbetur përdoret për në shpenzues të tjerë.

PATENTA EUROPIANE TË VLEFSHME

(11) **12780**

(97) EP4247291/ 21.08.2024

(96) 21816613.0/ 09.11.2021

(22) 12.11.2024

(21) [AL/P/2024/633](#)

(54) **STACION KIRURGJIK I ROBOTIZUAR**

18.03.2025

(30) US 202063117327 P 23/11/2020

(71) The Board of Trustees of the University of Illinois/ 352 Henry Administration Building, 506 S. Wright Street, Urbana, IL 61801 / US.

(72) Pier Cristoforo GIULIANOTTI/Chicago, Illinois 60612 / US; Andreas VOGLER/ 80801 Munich / DE.

(74) Krenar Loloçi // ZEF JUBANI; Nd. 15; H. 15; Ap. 26; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; NJËSIA BASHKIAKE NR. 5; 1019; TIRANË.

(57) 1. PRETENDIMET 1. Një stacion kirurgjik i robotizuar (1) , që përfshin: - një bazë (100) , e konfiguruar për t'u mbështetur përtokë; - një strukturë në formë unaze të pjesshme (210) , e lidhur në mënyrë rrëshqitëse me bazën e përmendur (210) në mënyrë që të jetë e rrotullueshme rreth një boshti rrotullimi (R) ortogonal në një profil rrethor të përcaktuar nga struktura në formë unaze të pjesshme (210) dhe që kalon përmes qendrës (C) së profilin rrethues në fjalë; - një tavolinë operacioni (600) , e kufizuar në një segment të parë të harkuar (211) të strukturës në formë unazore të pjesshme (210) në një montim të parë (220) ; - një numër krahësh robotikë (900) , të kufizuar në një segment të dytë të harkuar (212) të strukturës së lartpërmendur në formë unaze të pjesshme (210) në një montim të dytë (250) dhe të konfiguruar për t'u aktivizuar nga distanca nga një kirurg, ku segmenti i dytë i harkuar (212) i strukturës së lartpërmendur në formë unaze të pjesshme (210) është i rrotullueshëm anash rreth një boshti gjatësor (L) ortogonal me boshtin e rrotullimit (R) në lidhje me segmentin e parë të harkuar (211) në një mënyrë të tillë për të lejuar qasje të plotë në tryezën e operacionit (600) .

2. Stacioni kirurgjik i robotizuar (1) sipas pretendimit 1, ku struktura në fjalë me formë unaze të pjesshme (210) ka një profil harkor të formuar kryesisht si një hark rrethi, preferohet të mbulojë 270 gradë nga 360 gradë të një profili të plotë rrethues.

3. Stacioni kirurgjik i robotizuar (1) sipas ndonjë prej pretendimeve të mëparshme, përfshin një ose më shumë aktivizues bllokues (232) të vendosur midis segmentit të parë (211) dhe segmentit të dytë (212) harkor të strukturës me formë unaze të pjesshme (210) .

4. Stacioni kirurgjik i robotizuar (1) sipas ndonjë prej pretendimeve të mëparshme, ku struktura me formë unaze të pjesshme (210) ka një gamë rrotullimi prej 360 gradësh rreth boshtit të rrotullimit (R) .

5. Stacioni kirurgjik i robotizuar (1) sipas ndonjë prej pretendimeve të mëparshme, ku struktura me formë unaze të pjesshme (210) është e rrotullueshme rreth boshtit të rrotullimit (R) si në drejtim të akrepave të orës, ashtu edhe në kundër të akrepave të orës në lidhje me bazën (100) .

6. Stacioni kirurgjik i robotizuar (1) sipas ndonjë prej pretendimeve të mëparshme, ku baza (100) përfshin mjete zhvendosjeje, në veçanti rrota (110) , për t'u bërë e lëvizshme në një mjedis.

7. Stacioni kirurgjik i robotizuar (1) sipas pretendimit të mësipërm, ku baza (100) përfshin

një platformë tokësore (101) të montuar mbi mjetet e përmendura zhvendosëse (110) .

8. Stacioni kirurgjik i robotizuar (1) sipas ndonjë prej pretendimeve të mëparshme, ku montimi i parë (220) dhe/ose montimi i dytë (250) janë të rrotullueshëm në lidhje me bazën (100) rreth një boshti të përkuljes (P) të pingul me boshtin të rrotullimit (R) .

9. Stacioni kirurgjik i robotizuar (1) sipas pretendimit të mësipërm, ku rrotullimi i montimit të parë (220) dhe i montimit të dytë (250) rreth boshtit të përkuljes (P) është i sinkronizuar elektro-mekanikisht.

10. Stacioni kirurgjik i robotizuar (1) sipas pretendimit 8 ose 9, ku boshti i rrotullimit (R) dhe boshti i përkuljes (P) janë paralel me tokën në një konfiguracion pushimi të stacionit kirurgjik të robotizuar (1) .

11. Stacioni kirurgjik i robotizuar (1) sipas ndonjë prej pretendimeve të mëparshme, ku montimi i parë (220) dhe/ose montimi i dytë (250) kanë një strukturë teleskopike.

12. Stacioni kirurgjik i robotizuar (1) sipas ndonjë prej pretendimeve të mëparshme, ku montimi i parë (220) dhe/ose montimi i dytë (250) përfshijnë aktorë linearë hidraulikë ose elektromekanikë.

13. Stacioni kirurgjik i robotizuar (1) sipas ndonjë nga pretendimet e mëparshme, ku montimi i parë (220) dhe/ose i dytë (250) , apo pjesët e tij, janë të rrotullueshme rreth një boshti të shtrirjes (Y) pingul me boshtin e rrotullimit (R) dhe preferohet të jetë i konfiguruar në një pozicion pingul me tokën në një gjendje pushimi të stacionit kirurgjik të robotizuar (1) .

14. Stacioni kirurgjik i robotizuar (1) sipas ndonjë nga pretendimet e mëparshme, ku tavolina e operacionit (600) është e konfiguruar për t'u montuar në mënyrë të heqshme në strukturën me formë unaze të pjesshme (210) .

15. Stacioni kirurgjik i robotizuar (1) sipas ndonjë nga pretendimet e mëparshme, ku baza (100) përfshin elemente, në veçanti rafte (121, 122) , për integrimin e pajisjeve mjekësore, siç janë pajisjet për anestezi.

16. Stacioni kirurgjik i robotizuar (1) sipas ndonjë nga pretendimet e mëparshme, i cili përfshin njësinë e kontrollit në distancë (801) , e cila është e konfiguruar për t'u përdorur nga një kirurg për të komanduar një ose më shumë nga këto krahë robotikë (900) .

17. Stacioni kirurgjik i robotizuar (1) sipas ndonjë nga pretendimet e mëparshme, ku tavolina e operacionit (600) dhe krahët robotikë (900) janë të vendosur në anët e kundërta të strukturës me formë unaze të pjesshme (210) .

18. Stacioni kirurgjik i robotizuar (1) sipas ndonjë nga pretendimet e mëparshme, ku tavolina e operacionit (600) dhe/ose krahët robotikë (900) janë të rrotullueshëm në lidhje me bazën (100) rreth një boshti të përkuljes (P) pingul me boshtin e rrotullimit (R) dhe paralel me tokën në një gjendje pushimi të strukturës me formë unaze të pjesshme (210) .

(11) **12762**

(97) EP4001272/ 13.11.2024

(96) 21196371.5/ 30.10.2014

(22) 21.11.2024

(21) [AL/P/2024/653](#)

(54) **PROILAÇET ANTAGONISTE NMDA**

05.03.2025


(30) US 201361899903 P 05/11/2013

(71) Astrazeneca AB/ 151 85 Södertälje / SE


(72) NORDVALL, Gunna r/ Macclesfield, SK10 4TG / GB; HÖGDIN, Katharina / Macclesfield, SK10 4TG / GB; MALMBORG, Per Jonas/Macclesfield, SK10 4TG / GB; KERS, Annika/Macclesfield, SK10 4TG / GB; WEIGELT, Dirk/Macclesfield, SK10 4TG / GB; BERNSTEIN, Peter/Waltham, 02451 / US; QUIRK, Michael/Waltham, 02451 / US; BALESTRA, Michael/Waltham, 02451 / US.

(74) Fatos Dega // NIKOLLA TUPE; Nd. 2; H. 4; Ap. 30; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; NJËSIA BASHKIAKE NR. 5; 1019; TIRANË.

(57) 1. Një përbërës me formulë (I) :



ku R1 është;



ku AA është një aminoacid natyror me lidhje peptide,
ose një kripë farmaceutikisht e pranueshme e tij, për përdorim në një metodë për mjekimin
e depresionit.

2.Përbërësi për përdorim sipas pretendimit 1, ku përbërësi për zgjidhet nga grupi i përbërë
nga:

(S) -1-((S) -2-Amino-3-metilbutanoil) -N-((S) -1-fenil-2-(piridin-2-il) etil) pirrolidin-2-
karboksamid;

(57) 1. Një brejtës i modifikuar gjenetikisht, linja embrionale e të cilit përfshin: (a) një sekuençë nukleotide që kodon një molekulë MHC të njerëzore ose të humanizuar që përfshin të paktën një kanal peptid-lidhës human të një molekule të antigjenit leukocitor njerëzor (HLA) ose të paktën kanalin peptid-lidhës të saj; dhe (b) (i) një lokus të zinxhirit të rëndë të imunoglobulinës njerëzore ose të humanizuar të parisistemuar dhe/ose (ii) një lokus të zinxhirit të lehtë të imunoglobulinës njerëzore ose të humanizuar të parisistemuar, ku brejtësi i modifikuar gjenetikisht shpreh molekulën MHC të njeriut ose të humanizuar ose të paktën kanalin peptid-lidhës human të saj ku brejtësi i modifikuar gjenetikisht shpreh në një qelizë B humane ose të humanizuar një antitrop të njeriut ose të humanizuar që përfshin: (i) një domen variabël të zinxhirit të rëndë njerëzor ose të humanizuar, i shprehur nga një regjion variabël i zinxhirit të rëndë i imunoglobulinës të risistemuar i formuar nga lokusi i zinxhirit të rëndë i imunoglobulinës njerëzore ose të humanizuar në fjalë dhe/ose (ii) një domen variabël të zinxhirit të lehtë njerëzor ose të humanizuar, i shprehur nga një lokus i regjionit variabël i zinxhirit të lehtë të imunoglobulinës i risistemuar i formuar nga lokusi i zinxhirit të lehtë i imunoglobulinës njerëzore ose të humanizuar i parisistemuar në fjalë , ku brejtësi i modifikuar gjenetikisht tolerohet për: molekula e MHC e njeriut ose e humanizuar ose të paktën kanali i saj peptid-lidhës human, e tillë që ajo gjeneron një reagim të qelizës B specifike e cila gjeneron një antitrop njerëzor ose të humanizuar që: (A) lidh në mënyrë specifike një kompleks peptid-MHC antigjenik (pMHC) që përfshin (i) një peptid që është heterolog me brejtësin e modifikuar gjenetikisht i kompleksuar me të (ii) molekulën HLA ose të paktën kanalin peptid-lidhës human të saj, dhe (B) nuk lidh një molekulë HLA të zbrazët nga e cila rrjedh kanali peptid-lidhës, kur është e imunizuar me kompleksin pMHC antigjenik në fjalë, dhe ku brejtësi i modifikuar gjenetikisht përfshin edhe: (C) kompleksin pMHC antigjenik të përmendur, që përfshin: (i) peptidin e përmendur që është heterolog me brejtësin e modifikuar gjenetikisht të kompleksuar me të (ii) molekulën HLA në fjalë ose të paktën kanalin e saj human peptid-lidhës , dhe (d) antitropi i lartpërmendur njerëzor ose i humanizuar që lidh në mënyrë specifike kompleksin antigjenik pMHC të përmendur dhe nuk lidh molekulën e zbrazët HLA, dhe ku brejtësi gjenetikisht i modifikuar është një mi imadhe ose një mi i vogël.

2. Brejtësi i modifikuar gjenetikisht i pretendimit 1, ku molekula MHC e njeriut ose e

humanizuar për zgjidhet nga grupi që përbëhet nga një molekulë njerëzore ose e humanizuar MHC e klasës I, një molekulë njerëzore ose e humanizuar MHC e klasës II α , një molekulë njerëzore ose e humanizuar MHC e klasës II β , ose ndonjë kombinim të tyre, dhe/ose ku brejtësi i modifikuar gjenetikisht përfshin: (a) në një lokus të zinxhirit të rëndë endogjenoz: (i) një regjion variabël të zinxhirit të rëndë të imunoglobulinës njerëzore ose të humanizuar të parisistemuar në lidhje të operueshme me një regjion konstant të zinxhirit të rëndë endogjenoz; (ii) një regjion variabël të zinxhirit të rëndë njerëzor ose të humanizuar të parisistemuar i kufizuar në lidhje të operueshme me një regjion konstant të zinxhirit të rëndë endogjenoz; (iii) një sekuençë të zakonshme të kodimit të zinxhirit të rëndë; (iv) një regjion variabël të zinxhirit të rëndë njerëzor ose të humanizuar të parisistemuar i modifikuar me histidinë në lidhje të operueshme me një regjion konstant të zinxhirit të rëndë endogjenoz; (v) një sekuençë koduese e imunoglobulinës vetëm me zinxhir të rëndë; ose (vi) një sekuençë të zinxhirit të rëndë hibrid njerëzor ose të humanizuar të parisistemuar që kodifikon një zinxhir të imunoglobulinës hibride; dhe/ose (b) në një lokus të zinxhirit të lehtë endogjenoz: (i) një regjion variabël të zinxhirit të lehtë të imunoglobulinës njerëzore ose të humanizuar të parisistemuar në lidhje të operueshme me një regjion konstant të zinxhirit të lehtë endogjenoz; (ii) një sekuençë kodifikuese të zinxhirit të lehtë të zakonshme; (iii) një regjion variabël të zinxhirit të lehtë njerëzor ose të humanizuar të parisistemuar i kufizuar në lidhje të operueshme me një regjion konstant të zinxhirit të lehtë endogjenoz; (iv) një regjion variabël të zinxhirit të lehtë njerëzor ose të humanizuar të parisistemuar i modifikuar me histidinë në lidhje të operueshme me një regjion konstant të zinxhirit të lehtë endogjenoz; ose (v) një regjion variabël të zinxhirit të lehtë njerëzor ose të humanizuar të parisistemuar i modifikuar me histidinë në lidhje të operueshme me një regjion konstant të zinxhirit të lehtë endogjenoz.

3. Brejtësi i modifikuar gjenetikisht i pretendimit 1 ose i pretendimit 2, ku brejtësi i modifikuar gjenetikisht: (i) përfshin edhe një gjen funksional ADAM6, opsionalisht ku gjeni funksional ADAM6 është një gjen ADAM6 endogjenoz; dhe/ose (ii) shpreh edhe një gjen deoksinukleotidil transferase terminal eksogjenoz (TdT).

4. Brejtësi i modifikuar gjenetikisht i çdonjerit prej pretendimeve të mësipërme, ku molekula MHC njerëzore ose e humanizuar është një molekulë MHC njerëzore ose e humanizuar e klasës I, opsionalisht ku kanali peptid-lidhës human rrjedh nga një molekulë HLA e klasës I e përzgjedhur nga grupi që përfshin një molekulë HLA-A, një molekulë HLA-B, dhe një molekulë HLA-C, opsionalisht ku brejtësi i modifikuar gjenetikisht përfshin në gjenomin e tij edhe një sekuençë nukleotide që kodifikon një monoglobulin $\beta 2$ njerëzore ose të humanizuar, opsionalisht në një lokus mikroglobulin $\beta 2$ endogjenoz, ku brejtësi i modifikuar gjenetikisht shpreh mikroglobulinën $\beta 2$ njerëzore ose të humanizuar në mënyrë të tillë që brejtësi i modifikuar gjenetikisht tolerohet nga mikroglobulina $\beta 2$ njerëzore ose e humanizuar vetë ose së bashku me molekulën MHC e klasës I njerëzore ose e humanizuar.

5. Brejtësi i modifikuar gjenetikisht i çdonjerit prej pretendimeve 1-3, ku molekula MHC njerëzore ose e humanizuar është një molekulë MHC e klasës II njerëzore ose e humanizuar, opsionalisht ku kanali peptid-lidhës human rrjedh nga një zinxhir α dhe/ose nga një zinxhir β i një molekule HLA e klasës II e përzgjedhur nga grupi që përfshin një molekulë HLA-DP, një molekulë HLA-DQ, dhe një molekulë HLA-DR.

6. Brejtësi i modifikuar gjenetikisht i çdonjerit prej pretendimeve të mësipërme, ku sekuenca nukleotide që kodifikon molekulën MHC njerëzore ose të humanizuar ose të paktën kanalin peptid-lidhës human të saj, kodifikon një molekulë MHC plotësisht humane, opsionalisht ku sekuenca nukleotide që kodifikon një molekulë MHC plotësisht humane nuk këput një lokus

MHC të brejtësit endogjenoz, opsionalisht ku sekuenca nukleotide që kodifikon një molekulë plotësisht humane vendoset tek një lokus ROSA26 endogjenoz.

7. Brejtësi i modifikuar gjenetikisht i çdonjerit prej pretendimeve 1-5, ku sekuenca nukleotide që kodifikon molekulën MHC njerëzore ose të humanizuar ose të paktën kanalin peptid-lidhës human të saj, kodifikon një molekulë MHC kimerike njerëzore/të brejtësit që përfshin domenet jashtëqelizore të molekulës HLA e lidhur në mënyrë të operueshme me domenet transmembranore dhe citoplazmike të një molekule MHC endogjenoz, opsionalisht ku sekuenca nukleotide që kodifikon molekulën MHC njerëzore ose të humanizuar ose të paktën kanalin peptid-lidhës të saj, kodon: (i) një molekulë MHC kimerike njerëzore/e brejtësit e klasës I që përfshin domenet $\alpha 1$, $\alpha 2$ dhe $\alpha 3$ të një molekule HLA të klasës I e përzgjedhur nga grupi që përfshin HLA-A, HLA-B, dhe HLA-C e lidhur në mënyrë të operueshme me domenet transmembranore dhe citoplazmike të një molekule MHC të klasës I të brejtësit endogjenoz, siç është një polipeptid H-2K i miut endogjenoz, një polipeptid H-2D i miut endogjenoz, ose një polipeptid H-2L i miut endogjenoz, dhe/ose (ii) një molekulë MHC e klasës II kimerike njerëzore/e brejtësit që përfshin një domen $\alpha 1$ dhe një domen $\alpha 2$ të një polipeptidi HLA të klasës II α i lidhur në mënyrë të operueshme me domenet transmembranore dhe citoplazmike të një molekule MHC të klasës II α të brejtësit endogjenoz, siç është një polipeptid H-2A α i miut endogjenoz ose një polipeptid H-2E α i miut endogjenoz, dhe/ose një domen $\beta 1$ dhe një domen $\beta 2$ të një polipeptidi HLA të klasës II β i lidhur në mënyrë të operueshme me domenet transmembranore dhe citoplazmike të një molekule MHC të klasës II β të brejtësit endogjenoz, siç është një polipeptid H-2A β i miut endogjenoz ose një polipeptid H-2E β i miut endogjenoz.

8. Brejtësi i modifikuar gjenetikisht i çdonjerit prej pretendimeve të mësipërme, ku brejtësi i modifikuar gjenetikisht është heterozig për sekuençën nukleotide që kodifikon molekulën MHC njerëzore ose të humanizuar ose të paktën kanalin peptid-lidhës të saj.

9. Brejtësi i modifikuar gjenetikisht i çdonjerit prej pretendimeve të mësipërme, ku brejtësi i modifikuar gjenetikisht është një mi.

10. Metodë për prodhimin e një brejtësi të modifikuar gjenetikisht e çdonjerit prej pretendimeve të mësipërme, metodë e cila përfshin (1) modifikimin e gjenomit të një brejtësi për të përfshirë: (a) një sekuençë nukleotide që kodifikon një molekulë MHC njerëzore ose të humanizuar që përmban të paktën një kanal peptid-lidhës human të një molekule HLA ose të paktën një kanal peptid-lidhës human të saj, dhe (b) një lokus të zinxhirit të rëndë të imunoglobulinës njerëzore ose të humanizuar të parisistemuar dhe/ose një lokus të zinxhirit të lehtë të imunoglobulinës njerëzore ose të humanizuar të parisistemuar, dhe (2) përdorimin tek brejtësi i një kompleksi pMHC antigjenik që përfshin një peptid heterolog tek brejtësi i shoqëruar me molekulën HLA e përmendur ose të paktën kanalin peptid-lidhës human të saj, ku brejtësi i modifikuar gjenetikisht është: A. i toleruar ndaj molekulës MHC njerëzore ose të humanizuar ose të paktën kanalit peptid-lidhës human të saj e tillë që ai gjeneron një reagim të qelizës B specifike e cila gjeneron një antitrop njerëzor ose të humanizuar që (A) lidh në mënyrë specifike një kompleks pMHC antigeni i cili përfshin (i) një peptid që është heterolog ndaj brejtësit të modifikuar gjenetikisht i kompleksuar me (ii) molekulën HLA ose të paktën me kanalin peptid-lidhës human të saj, dhe (B) nuk lidhet me një molekulë HLA të zbrazët nga e cila rrjedh kanali peptid-lidhës human, kur është e imunizuar me kompleksin pMHC antigjenik të përmendur, dhe B. i aftë për të shprehur nga qeliza B antitropin njerëzor ose të humanizuar të përmendur i cili përfshin: (i) një domen variabël të zinxhirit të rëndë njerëzor ose të humanizuar, i shprehur nga një lokus i regjionit variabël i zinxhirit të rëndë të imunoglobulinës i risistemuar i formuar nga lokusi i zinxhirit të rëndë i imunoglobulinës

njerëzore ose e humanizuar i parsisistemuar në fjalë; dhe/ose (ii) një domen variabël të zinxhirit të lehtë njerëzor ose të humanizuar, i shprehur nga një lokus i regjionit variabël i zinxhirit të lehtë të imunoglobulinës të risistemuar i formuar nga lokusi i zinxhirit të lehtë të imunoglobulinës njerëzore ose i humanizuar parsisistemuar në fjalë, dhe ku brejtësi është një mi i madh ose një mi i vogël.

11. Metoda e pretendimit 10, ku kjo metodë përfshin: (a) (1) futjen e sekuencës nukleotide që kodifikon molekulën MHC njerëzore ose të humanizuar ose të paktën kanalin peptid-lidhës të saj në një lokus ektopik të parë, ose (2) zëvendësimin: në një lokus të MHC I të brejtësit endogjenoz, e një sekuence nukleotide që kodifikon një polipeptid të MHC I të brejtësit me një sekuencë nukleotide që kodifikon një polipeptid MHC I njerëzor ose të humanizuar për të formuar një sekuencë nukleotide që kodifikon molekulën MHC njerëzore ose të humanizuar, dhe/ose në një lokus të MHC II të brejtësit endogjenoz, një sekuencë nukleotide që kodifikon një polipeptid të MHC II të brejtësit me një sekuencë nukleotide që kodifikon një polipeptid të MHC II njerëzore ose të humanizuar për të formuar një sekuencë nukleotide që kodifikon molekulën MHC njerëzore ose të humanizuar, dhe (b) (i) futjen e lokusit të zinxhirit të rëndë të imunoglobulinës njerëzore ose të humanizuar të parsisistemuar dhe/ose të lokusit të zinxhirit të lehtë të imunoglobulinës njerëzore ose të humanizuar të parsisistemuar tek një lokus i dytë ektopik, ose (ii) zëvendësimin (A) në një lokus të zinxhirit të rëndë të brejtësit endogjenoz, e një segmenti të gjenit variabël të zinxhirit të rëndë (VH) të imunoglobulinës të brejtësit endogjenoz me një segment të gjenit variabël të zinxhirit të rëndë (VH) të imunoglobulinës humane të parsisistemuar, dhe opsionalisht zëvendësimin e një segmenti të gjenit të diversitetit të zinxhirit të rëndë (DH) të imunoglobulinës të brejtësit endogjenoz dhe/ose një segment të gjenit bashkues të zinxhirit të rëndë (JH) të imunoglobulinës të brejtësit endogjenoz me një segment të gjenit të diversitetit të zinxhirit të rëndë (DH) të imunoglobulinës humane të parsisistemuar dhe/ose një segment i gjenit bashkues të zinxhirit të rëndë (JH) të imunoglobulinës humane të parsisistemuar, respektivisht, ku segmenti i gjenit VH human i parsisistemuar, dhe segmenti i gjenit DH human i parsisistemuar opsional dhe segmenti i gjenit JH human të parsisistemuar opsional janë lidhur në mënyrë të operueshme me një sekuencë të gjenit të regjionit konstant të zinxhirit të rëndë endogjenoz, dhe/ose (B) në një lokus të zinxhirit të lehtë të brejtësit endogjenoz, e një segmenti të gjenit variabël i zinxhirit lehtë (VL) të imunoglobulinës të brejtësit endogjenoz dhe e një segmenti të gjenit bashkues të zinxhirit të lehtë (JL) të imunoglobulinës të brejtësit endogjenoz me një segment të gjenit variabël të zinxhirit të lehtë (VL) të imunoglobulinës humane dhe një segment të gjenit bashkues të zinxhirit të lehtë JL të imunoglobulinës humane, të cilët janë opsionalisht të risistemuar për të formuar një sekuencë të gjenit VL/JL, ku segmentet e gjenit human VL dhe gjenit human JL lidhen në mënyrë të operueshme me një sekuencë të gjenit të regjionit konstant të zinxhirit të lehtë endogjenoz, ku: (A) sekuenca nukleotide (a) (1) që kodifikon molekulën MHC njerëzore ose të humanizuar ose të paktën kanali peptid-lidhës human i saj dhe lokusi i zinxhirit të rëndë të imunoglobulinës njerëzore ose të humanizuar të parsisistemuar (b) (i) dhe/ose lokusi i zinxhirit të lehtë të imunoglobulinës njerëzore ose të humanizuar të parsisistemuar janë: (I) janë insertuar nëpërmjet rikombinimeve të vazhdueshme homologe në një qelizë të vetme embrionale të brejtësit (ES) . ose (II) janë insertuar tek një qelizë e parë dhe e dytë ES, ku qeliza e parë dhe e dytë ES në fjalë përdoren respektivisht për të gjeneruar një brejtës të modifikuar gjenetikisht të parë dhe të dytë; ose (B) sekuenca nukleotide (a) (2) që kodifikon polipeptidin e MHC I të brejtësit dhe/ose sekuenca nukleotide që kodifikon polipeptidin e MHC II të brejtësit , dhe brejtësi endogjenoz VH (b) (ii) dhe opsionalisht segmentet e gjenit

DH dhe/ose JH, dhe/ose segmentet e gjenit të VL ose JL të brejtësit endogjenoz janë : (I) janë zëvendësuar nëpërmjet rikombinimeve të vazhdueshme homologe në një qelizë të vetme embrionale të brejtësit (ES) ; ose (II) janë zëvendësuar tek një qelizë e parë dhe e dytë ES, ku qeliza e parë dhe e dytë ES përdoren respektivisht për të gjeneruar një brejtës të modifikuar gjenetkisht të parë dhe të dytë.

1. Metoda e pretendimit 10 ose e pretendimit 11, ku kompleksi pMHC antigjenik lidhet me një epitop të qelizës T ndihmëse, opsionalisht ku epitopi i qelizës T ndihmëse është PADRE.

13. Metoda e pretendimit 11(a) (2) , ku një molekulë MHC I e humanizuar përfshin domenet $\alpha 1$, $\alpha 2$, dhe $\alpha 3$ të një molekule HLA të klasës I dhe të paktën domene transmembranore dhe citoplazmike të një polipeptidi të MHC I të brejtësit endogjenoz , dhe/ose ku një molekulë MHC II e humanizuar përfshin domenet $\alpha 1$, $\alpha 2$, $\beta 1$ dhe $\beta 2$ të një molekule HLA të klasës II dhe të paktën domenet transmembranore dhe citoplazmike të një polipeptidi të MHC II të brejtësit endogjenoz.

14. Metoda e pretendimit 11(a) (2) , e cila përfshin sekuenca targetuese që kodifikojnë një domen jashtëqelizor të polipeptidit të MHC endogjenoz, mikroglobulinën $\beta 2$ endogjenoz, dhe regjione variable të imunoglobulinës endogjenoz dhe duke i zëvendësuar ato, respektivisht, me sekuenca që kodifikojnë një domen jashtëqelizor të polipeptidit të MHC human, mikroglobulinën humane $\beta 2$, dhe regjione variabël të imunoglobulinës humane.

15. Metodë për gjenerimin e një antitrupi njerëzor ose të humanizuar që lidh në mënyrë specifike një kompleks interesi antigjenik pMHC ose një sekuencë të acidit nukleik që kodifikon të njëjtën duke përfshirë mbajtjen në rregull të brejtësit gjenetkisht të modifikuar sipas çdonjerit prej pretendimeve 1-9 ose të prodhuar sipas metodës të çdonjerit prej pretendimeve 10-14 në kushte të mjaftueshme për brejtësin e modifikuar gjenetkisht për të krijuar një reagim imun ndaj kompleksit të interesit pMHC antigjenik, ku kompleksi i interesit pMH antigjenik përfshin një peptid që është heterolog tek brejtësi i modifikuar gjenetkisht dhe është i pranishëm në kontekstin e molekulës HLA ose të paktën të kanalit peptid-lidhës të saj, opsionalisht që përfshin si një hap të parë imunizimin e brejtësit të modifikuar gjenetkisht me kompleksin e interesit pMHC antigjenik, dhe opsionalisht edhe duke nxitur reagimin imun të brejtësit gjenetkisht të imunizuar, opsionalisht ku imunizimi dhe/ose nxitja përfshijnë përdorimin tek brejtësi i modifikuar gjenetkisht i kompleksit të interesit antigjenik pMHC të lidhur me një epitop të qelizës T ndihmëse, opsionalisht ku epitopi i qelizës T ndihmëse përfshin PADRE të shprehur si SEQ ID NO: 28.

16. Metodë për përfitim të një acidi nukleik që kodifikon një domen variabël të zinxhirit të rëndë të imunoglobulinës humane dhe/ose një domen variabël të zinxhirit të lehtë të imunoglobulinës humane, metodë e cila përfshin: izolimin nga një brejtës gjenetkisht i modifikuar sipas çdonjerit prej pretendimeve 1-9 ose i prodhuar sipas metodës të çdonjerit prej pretendimeve 10-14, të një acidi nukleik që përfshin një sekuencë të gjenit të regjionit variabël të imunoglobulinës humane të risistemuar, opsionalisht ku sekuenca e gjenit të regjionit variabël të imunoglobulinës humane të risistemuar përfshin të paktën një hipermutacion somatik, që kodifikon një domen variabël të imunoglobulinës humane të shprehur nga një limfocitë e brejtësit të modifikuar gjenetkisht, ose nga një hibridomë e prodhuar nga limfocitja, ku domeni variabël i imunoglobulinës humane i shprehur nga limfocitja, ose hibridoma e prodhuar prej saj, bashkohet me domenin e saj variabël të afërt për të formuar një domen antigen-lidhës specifik për kompleksin pMHC antigjenik.

17. Metodë për përfitim të një qelize që shpreh një domen variabël të zinxhirit të rëndë të imunoglobulinës humane dhe/ose një domen variabël të zinxhirit të lehtë të imunoglobulinës humane, metodë e cila përfshin Izolimin e një limfociti nga një brejtës i modifikuar

gjenetikisht sipas çdonjerit prej pretendimeve 1-9 ose i prodhuar sipas metodës të çdonjerit prej pretendimeve 10-14, ku limfociti shpreh një domen variabël të imunoglobulinës humane që formon një domen antigen-lidhës specifik për kompleksin pMHC antigjenetik.

18. Metoda e pretendimit 17, e cila përfshin edhe prodhimin e hibridoma-s nga një limfocite e izoluar.

19. Metodë in vitro për prodhimin e një domeni variabël të imunoglobulinës humane, metodë e cila përfshin: shprehjen, në një qelizë, e një acidi nukleik të parë që përfshin një sekuencë të gjenit të regjionit variabël të imunoglobulinës humane të risistemuar që kodifikon një domen variabël të imunoglobulinës humane e shprehur nga një limfocite e një brejtësi gjenetikisht të modifikuar sipas çdonjerit prej pretendimeve 1-9 ose i prodhuar sipas metodës të çdonjerit prej pretendimeve 10-14, ose një hibridomë e prodhuar nga limfociti, ku domeni variabël i imunoglobulinës humane i shprehur nga limfociti, ose hibridoma e prodhuar prej saj, bashkohet me domenin e saj variabël të afërt për të formuar një domen antigen-lidhës që është specifik për kompleksin pMHC antigjenik, opsionalisht ku acidi i parë nukleik përfshin edhe një sekuencë të gjenit të regjionit konstant të imunoglobulinës humane i lidhur në mënyrë të operueshme me sekuencën e gjenit të regjionit variabël të imunoglobulinës humane të risistemuar, opsionalisht ku sekuenca e gjenit të regjionit konstant të imunoglobulinës humane është një sekuencë e gjenit të regjionit konstant të zinxhirit të rëndë dhe përfshin një modifikim që rrit afërsinë e një regjioni CH2-CH3 të një sekuence amino acide të regjionit konstant të zinxhirit të rëndë IgG me receptorin Fc (FcRn) në një pH që varion nga 5.5 deri në 6.0, ku modifikimi është një mutacion në sekuencën amino acide të regjionit konstant të zinxhirit të rëndë IgG të përzgjedhur nga grupi i përbërë nga M428L, N434S, V259I, V308F, N434A, M252Y, S254T, T256E, T250Q, H433K, N434Y, dhe një kombinim i tyre.

(11) **12786**

(97) EP3464380/ 06.11.2024

(96) 17734131.0/ 02.06.2017

(22) 28.01.2025

(21) [AL/P/2025/44](#)

(54) **REGJIM DOZIMI PËR PROTEINËN E BASHKIMIT TCR GP100-SPECIFIKE - SCFV ANTI-CD3**

18.03.2025

(30) GB 201609683 02/06/2016 ,GB 201612193 13/07/2016 ,GB 201612260 14/07/2016

(71) Immunocore Limited/ 92 Park Drive, Milton Park, Abingdon, Oxfordshire OX14 4RY / GB,

(72) Christina COUGHLIN/c/o Immunocore LLC Six Tower Bridge Suite 540 181 Washington Street Conshohocken Philadelphia Pennsylvania 19428 / US.

(74) Krenar Loloçi // ZEF JUBANI; Nd. 15; H. 15; Ap. 26; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; NJËSIA BASHKIAKE NR. 5; 1019; TIRANË.

(57) 1. Një qelizë T ridrejtuese bispecifike terapeutike e cila përfshin (i) një pjesë të synuar që lidh kompleksin YLEPGPVTA-HLA-A2 të bashkuar te (ii) një pjesë e ridrejtimit të qelizave T lidhëse CD3, ku pjesa e synuar është një receptor i qelizës T (TCR) , pjesa e ridrejtimit të qelizave T lidhëse CD3 është një antitrop anti-CD3, dhe terapeutika bispecifike përfshin një sekuencë të vargut alfa TCR të SEQ ID NO: 4 dhe një sekuencë të vargut-anti-CD beta TCR të SEQ ID NO: 5, për përdorim në një metodë të trajtimit të kancerit gp 100 pozitiv në një pacient që përfshin administrimin e terapeutikës bispecifike te pacienti i sipërpërmendur me anë të infuzionit intravenoz në (a) të paktën një dozë të parë në intervalin prej 10 deri në 30 µg; (b) të paktën një dozë të dytë në intervalin prej 20 deri në 40 µg, ku çdo dozë e dytë është më e lartë se doza e parë; dhe pastaj (c) të paktën një dozë në intervalin prej 50 deri në 70 µg, ku secila dozë është administruar çdo 5-10 ditë.

2. Terapeutika bispecifike për përdorim e pretendimit 1, ku secila dozë është administruar çdo 7 ditë.

3. Terapeutika bispecifike për përdorim e pretendimit 1 ose pretendimit 2, ku doza e parë është 20 µg dhe doza e dytë është 30 µg.

4. Terapeutika bispecifike për përdorim e ndonjërit pretendimit të mëparshëm, ku dy dozat e dyta janë administruar.

5. Terapeutika bispecifike për përdorim e ndonjërit pretendim të mëparshëm, e cila është administruar në kombinim me një ose më shumë terapi anti-kancer.

6. Terapeutika bispecifike për përdorim e pretendimit 5, ku terapia anti-kancer është durvalumab, tremelimumab, galunisertib dhe merestinib.

7. Terapeutika bispecifike për përdorim e pretendimit 6, ku terapia anti-kancer është merestinib dhe doza e merestinibit është në intervalin prej 40 deri në 120 mg një herë në ditë, në mënyrë të preferuar në intervalin prej 80 deri në 120 mg një herë në ditë.

8. Terapeutika bispecifike për përdorim e çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 4, ku terapeutika bispecifike është administruar si një monoterapi.

9. Terapeutika bispecifike për përdorim e ndonjërit pretendim të mëparshëm, ku kanceri gp100 pozitiv është melanoma.

10. Terapeutika bispecifike për përdorim e pretendimit 9, ku melanoma është melanoma e Fazës III ose melanoma e Fazës IV.

11. Terapeutika bispecifike për përdorim e pretendimit 9 ose pretendimit 10, ku melanoma inkludon leziona metastatike.

12. Terapeutika bispecifike për përdorim e çdo njërit prej pretendimeve 9 deri në 11, ku melanoma është melanoma kutane.
13. Terapeutika bispecifike për përdorim e çdo njërit prej pretendimeve 9 deri në 11, ku melanoma është melanoma uveale.

(11) **12755**

(97) EP4256196/ 08.01.2025

(96) 21814921.9/ 24.11.2021

(22) 28.01.2025

(21) [AL/P/2025/45](#)

(54) **SISTEM PËR PRODHIM ENERGJIE**

04.03.2025

(30) IT 202000029351 01/12/2020

(71) Sizable Energy S.r.l./ Via Giorgio Washington, 96, c/o Milano Multiphysics, 20146 Milano (MI) / IT.

(72) Manuele AUFIERO/20146 Milano / IT.

(74) Krenar Loloçi // ZEF JUBANI; Nd. 15; H. 15; Ap. 26; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; NJËSIA BASHKIAKE NR. 5; 1019; TIRANË.

(57) 1. Sistem për prodhim energjie (1) , që përmban: -një turbinë hidraulike (2) , e montueshme përgjatë një tubi furnizues (3) dhe e aftë të rrotullohet në një drejtim të parë rrotullues nga efekti i rrjedhës së lëngut që kalon në tubin furnizues (3) në drejtim për poshtë; -një grup konvertues energjie (4) , i lidhur me turbinën hidraulike (2) ; -një akumulator (5) , i lidhur me grupin konvertues të energjisë (4) ; -një njësi kontrolli (6) , e konfiguruar për të operuar sistemin (1) në një mënyrë prodhimi energjie, ku grupi konvertues i energjisë (4) merr një fuqi mekanike hyrëse nga turbina hidraulike (2) që rrotullohet në drejtimin e parë rrotullues nga efekti i rrjedhës së lëngut, gjeneron një energji elektrike nxjerrëse dhe e furnizon këtë energji elektrike nxjerrëse në një rrjet të jashtëm (7) dhe/ose në akumulatorin (5) , ku njësia e kontrollit (6) konfigurohet më tej që të operojë sistemin (1) në një mënyrë shtytjeje për poshtë, ku grupi konvertues i energjisë (4) thith një energji elektrike hyrëse nga akumulatori (5) dhe gjeneron një energji mekanike nxjerrëse për të lëvizur turbinën hidraulike (2) ; ku, në mënyrën e shtytjes për poshtë, grupi konvertues i energjisë (4) është i konfiguruar t'i japi energji turbinës hidraulike (2) për ta lëvizur atë në drejtimin e parë rrotullues të përmendur; që karakterizohet në atë që njësia e kontrollit (6) është e konfiguruar që të marrë një sinjal përfaqësues të një kërkesë për rezervë nga rrjeti dhe për të vendosur sistemin (1) në mënyrën e shtytjes për poshtë, si përgjigje ndaj sinjalit të përmendur; ku sinjali përmendur përfshin një energji të caktuar dalëse dhe një afat kohor brenda të cilit kjo energji e caktuar nxjerrëse duhet të furnizohet në rrjetin e jashtëm (7) .

2. Sistem për prodhim energjie (1) sipas pretendimit 1, i cili përfshin një inverter të parë (82) të lidhur midis akumulatorit (5) dhe grupit konvertues të energjisë (4) , ku, në mënyrën e shtytjes për poshtë, inverteri i parë (82) është i konfiguruar për të marrë një rrymë direkte nga akumulatori (5) dhe për të furnizuar një rrymë alternative te grupi konvertues i energjisë (4) , ku njësia e kontrollit (6) është e konfiguruar për të mbajtur sistemin (1) në mënyrën e shtytjes për poshtë deri sa energjia elektrike hyrëse e furnizuar nga akumulatori (5) te grupi konvertues i energjisë (4) të arrijë një vlerë maksimale të lidhur me inverterin e parë (82) ose me pajisje të tjera elektrike.

3. Sistem për prodhim energjie (1) sipas secilit prej pretendimeve të mëparshëm, që përfshin

gjithashtu një sensor të konfiguruar për të kapur një sinjal rrjedhjeje përfaqësues të shkallës së rrjedhjes së lëngut në drejtim për poshtë brenda tubit furnizues (3) , ku njësia e kontrollit (6) është e konfiguruar për të mbajtur sistemin (1) në mënyrën e shtytjes për poshtë derisa shkalla e rrjedhjes për poshtë, e kapur nga sensori, të arrijë një vlerë të paracaktuar.

4. Sistem për prodhim energjie (1) sipas secilit prej pretendimeve të mëparshme, ku turbina hidraulike (2) është një turbinë me rrjedhje aksiale.

5. Sistem për prodhim energjie (1) sipas secilit prej pretendimeve të mëparshëm, që më tej përfshin: -një inverter të dytë (83) të lidhur midis akumulatorit (5) dhe rrjetit të jashtëm (7) ; ku, në mënyrën e shtytjes për poshtë, njësia e kontrollit (6) është e konfiguruar për të kontrolluar inverterin e dytë (83) , në mënyrë të tillë që akumulatori (5) , më tej të furnizojë energji elektrike hyrëse te grupi konvertues i energjisë (4) , të furnizojë një energji shtesë elektrike nxjerrëse në rrjetin e jashtëm (7) .

6. Sistemi prodhimi energjie (1) sipas secilit prej pretendimeve të mëparshëm, ku njësia e kontrollit (6) më tej është konfiguruar për të operuar sistemin (1) në një mënyrë pompimi, në të cilën grupi konvertues i energjisë (4) të thithi një energji elektrike shtesë hyrëse nga rrjeti i jashtëm (7) dhe/ose nga akumulatori (5) dhe të gjenerojë një energji mekanike nxjerrëse shtesë për të lëvizur turbinën hidraulike (2) në një drejtim të dytë rrotullues, të kundërt me drejtimin e parë rrotullues, për të bërë që lëngu në tubin furnizues (3) të rrjedhë në një drejtim për lart, të kundërt me drejtimin për poshtë.

7. Sistem për prodhim energjie (1) sipas secilit prej pretendimeve të mëparshëm, ku akumulatori (5) përfshin superkapacitorë.

8. Një central energjie (10) që përfshin: - sistemin e prodhimit të energjie (1) sipas secilit prej pretendimeve të mëparshme; -një rezervuar të parë (91) ; -një tub furnizues (3) , ku tubi furnizues (3) ka një skaj të parë të lidhur me rezervuarin e parë (91) dhe një skaj të dytë të kundërt me skajin e parë, ku skaji i dytë ka një lartësi më të ulët se skaji i parë, dhe ku turbina hidraulike (2) lidhet me tubin furnizues (3) midis skajit të parë dhe skajit të dytë.

9. Central energjetik sipas pretendimit 8, që përfshin një rezervuar të dytë (92) të lidhur me skajin e dytë të tubit furnizues (3) , ku rezervuari i dytë (92) ka një lartësi më të ulët në krahasim me rezervuarin e parë (91) .

10. Central (10) sipas pretendimit 8 ose 9, ku tubi furnizues (3) ka një pjerrësi ekuivalente në harkun nga 10% deri 30%.

11. Një metodë për menaxhimin e një sistemi për prodhim energjie (1) , ku sistemi për prodhimin e energjisë (1) përfshin një turbinë hidraulike (2) , të montueshme përgjatë një tubi furnizues (3) , një grup konvertues energjie (4) , një akumulator (5) dhe një njësi kontrolli (6) , ku metoda përmban hapat e mëposhtëm: -operimin e sistemit (1) në mënyrën e prodhimit të energjisë, në të cilën grupi konvertues i energjisë (4) merr një energji mekanike hyrëse nga turbina hidraulike (2) , e cila rrotullohet në një drejtim të parë rrotullues nga efekti i një lëngu rrjedhës në tubin furnizues (3) në drejtim për poshtë, ku grupi konvertues i energjisë (4) gjeneron një energji elektrike nxjerrëse dhe e furnizon energjinë elektrike nxjerrëse të përmendur në rrjetin e jashtëm (7) dhe/ose në akumulator (5) ; ku metoda përmban një hap të operimit të sistemit (1) në një mënyrë shtytjeje për poshtë, në të cilën grupi konvertues i energjisë (4) thith një energji elektrike hyrëse nga akumulatori (5) dhe gjeneron një energji mekanike nxjerrëse për të lëvizur turbinën hidraulike (2) , ku, në mënyrën e shtytjes për poshtë, grupi konvertues i energjisë (4) i jep energji turbinës hidraulike (2) për ta lëvizur atë në drejtimin e parë rrotullues të përmendur, me qëllim që turbina hidraulike (2) të lëvizë në drejtimin e parë rrotullues të përmendur nga efekti i grupit konvertues të energjisë (4) dhe të sigurojë përsheptimin e rrjedhës së lëngut në drejtimin për poshtë; që karakterizohet në atë

që njësia e kontrollit (6) është e konfiguruar për të marrë një sinjal përfaqësues të një kërkesë për rezervë nga rrjeti dhe për të vendosur sistemin (1) në mënyrën e shtytjes për poshtë, si përgjigje ndaj këtij sinjali; ku sinjali i përmendur përfshin një energji nxjerrëse të caktuar dhe një afat kohor brenda të cilit energjia nxjerrëse e përmendur duhet të furnizohet në rrjetin e jashtëm (7).

12. Metodë sipas pretendimit 11, ku, në mënyrën e shtytjes për poshtë, akumulatori (5), përveç furnizimit të energjisë elektrike hyrëse të përmendur te grupi konvertues i energjisë (4), furnizon një energji elektrike nxjerrëse shtesë në rrjetin e jashtëm (7).

13. Metodë sipas pretendimit 11 ose 12, ku lëngu që rrjedh në tubin furnizues (3) ka një densitet të parë, ku tubi furnizues (3) lidh një rezervuar të parë (91) me një rezervuar të dytë (92) që ka një lartësi më të ulët në krahasim me rezervuarin e parë (91), dhe ku rezervuari i dytë (92) është i zhytur funksionalisht në një lëng mjedisor që ka një densitet të dytë të ndryshëm nga densiteti i parë, dhe tubi furnizues (3) është të paktën pjesërisht i zhytur funksionalisht në lëngun mjedisor të përmendur.

(11) **12763**

(97) EP4219647/ 25.12.2024

(96) 23164333.9/ 30.04.2019

(22) 31.01.2025

(21) [AL/P/2025/60](#)

(54) **KONTEINER QË PËRMBAN PËRBËRJE TË FLUOROLEFINËS SË STABILIZUAR**

07.03.2025

(30) US 201862664751 P 30/04/2018

(71) The Chemours Company FC, LLC/ 1007 Market Street, Wilmington DE 19801 / US.

(72) Peng, Sheng/Hockessin, 19707 / US; Sun-Blanks, Jian/Earleville, 21909 / US; Minor, Barbara Haviland/Elkton, 32163 / US; Kipp, Brian E./Avondale, 19311 / US; Koban, Mary E./Chadds Ford, 19317 / US.

(74) Fatos Dega // NIKOLLA TUPE; Nd. 2; H. 4; Ap. 30; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; NJËSIA BASHKIAKE NR. 5; 1019; TIRANË.

(57) 1. Një kontejner që përmban një përbërje ftohëse, ku përbërja përfshin (i) të paktën një fluorlefinë që përmban të paktën një anëtar të HFO-1234yf dhe HFO-1234ze, (ii) 30 ppm deri në 3,000 ppm në peshë, kundrejt peshës totale të përbërjes, e të paktën një frenuesi të përzgjedhur nga grupi i përbërë nga limonen, α -terpinen dhe α -tokoferol, dhe (iii) një anëtar të përzgjedhur nga grupi i përbërë nga ajri, oksigjeni, hidroperoksidi i kumenit dhe poliperoksidet, peroksidet, hidroperoksidet, persulfatet, perkarbonatet, perboratet dhe hidropersulfatet, dhe ku përbërja përmban më pak se 0,03 % në peshë të produkteve oligomerike, homopolimere ose polimerikë të tjerë.

2. Kontejneri sipas Pretendimit 1, ku kontejneri është një enë e mbyllur, për ruajtjen e përbërjes në faza të gazta dhe/ose të lëngshme, ku përqendrimi i oksigjenit dhe/ose i ujit në fazën e gaztë dhe/ose të lëngët varion nga 3 vol ppm në më pak se 3,000 vol ppm në temperaturën rreth 25°C, mundësisht nga 5 vol ppm në më pak se 1,000 vol ppm, dhe më preferueshëm nga rreth 5 vol ppm në më pak se 500 vol ppm.

3. Kontejneri sipas Pretendimit 1 ose 2 që është një rezervuar, një cilindër mbushës ose një cilindër mbushës dytësor.

4. Kontejneri sipas cilitdo prej Pretendimeve 1 deri në 3, ku kontejneri është i ndërtuar prej

çeliku me karbon, çeliku me mangan, çeliku me krom-molibden, çeliku pak të lidhur, çeliku inox ose lidhje alumini.

5. Kontejneri sipas cilitdo prej Pretendimeve 1 deri në 4, ku kontejneri përfshin një majë shpuese ose valvola të përshtatshme për shpërndarjen e lëndëve të ndezshme.

6. Kontejneri sipas cilitdo prej Pretendimeve 1 deri në 5, ku përbërja përmban më tej të paktën një lubrifikant.

7. Kontejneri sipas cilitdo prej Pretendimeve 1 deri në 6, ku përbërja përfshin edhe të paktën një anëtar të përzgjedhur nga grupi i përbërë nga HFC-32, HFC-125, HFC-134a, HFC-152a, 236fa, HFC-227ea dhe dioksid karboni; dhe/ose të paktën një anëtar të përzgjedhur nga grupi i përbërë nga HFC-134a, HFO-1243zf, HFO-1225ye, 3,3,3-trifluor-1-propin, HCFO-1233xf, HFC-244bb dhe HFC-245cb; dhe/ose të paktën një anëtar të përzgjedhur nga grupi i përbërë nga HCC-40, HCFC-22, CFC-115, HCFC-124, HCFC-1122, dhe CFC-1113; dhe/ose të paktën një anëtar të përzgjedhur nga grupi i përbërë nga HFO-1225yeZ, HFO-1243zf, HFC-236ea, HFC-245fa dhe 3,3,3-trifluorpropinë.

8. Kontejneri sipas cilitdo prej Pretendimeve 1 deri në 7, ku përbërja përmban edhe të paktën një anëtar të përzgjedhur nga grupi i përbërë nga hidroksitoluen i butiluar, hidroksianisol i butiluar, terciar-butilhidrokinon, galat, 2-fenil-2-propanol, 1-(2 ,4,5-trihidroksifenil) -1-butanon, fenolikë, derivate të metanit të bisfenolit dhe 2,2'-metilen bis (4-metil-6-t-butil fenol) .

9. Kontejneri sipas cilitdo prej Pretendimeve 1 deri në 8, ku frenuesi përmban të paktën një limonen dhe α -terpinen.

10. Kontejneri sipas cilitdo prej Pretendimeve 1 deri në 9, ku përbërja është në thelb pa të paktën një nga të dy: amoniaku dhe CF3I.

11. Kontejneri sipas cilitdo prej Pretendimeve 1 deri në 5, ku përbërja përbëhet kryesisht nga HFO-1234yf dhe limonen dhe është në thelb pa të paktën një nga të dy: amoniaku dhe CF3I, mundësisht nuk përmban amoniak ose CF3I.

12. Kontejneri sipas cilitdo prej Pretendimeve 1 deri në 5, ku përbërja përbëhet kryesisht nga HFO-1234yf, 3,3,3-trifluorpropinë dhe limonen.

(11) **12782**

(97) EP3998069/ 11.12.2024

(96) 21200495.6/ 29.06.2016

(22) 03.02.2025

(21) [AL/P/2025/66](#)

(54) NANOGRIMCA QË PËRFSHIJNË SIROLIMUS DHE NJË ALBUMINË PËR PËRDORIM NË TRAJTIMIN E TUMOREVE TË QELIZAVE EPITELIOIDE

18.03.2025

(30) US 201562186252 P 29/06/2015

(71) Abraxis BioScience, LLC/ 86 Morris Avenue, Summit, NJ 07901 / US.

(72) NEIL P. DESAI/Pacific Palisades, 90272 / US.

(74) Krenar Loloçi // ZEF JUBANI; Nd. 15; H. 15; Ap. 26; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; NJËSIA BASHKIAKE NR. 5; 1019; TIRANË.

(57) 1. Një kompozim që përfshin nanogrimca që përfshin sirolimus dhe një albuminë për përdorim në një metodë të trajtimit të një tumori malinj të qelizave epitelioid perivaskulare (PEComa) në një individ, ku metoda përfshin administrimin e kompozimit të nanogrimcës në mënyrë intravenoze dhe ku sirolimusi është administruar te individi në një dozë prej 10 mg/m² deri në 150 mg/m².

2. Kompozimi për përdorim i pretendimit 1, ku PEComa është zgjedhur nga grupi i përbërë prej një tumori të “sheqerit” me qeliza të qarta pulmonare, një PEComa e paspecifikuar ndryshe (PEComa-NOS) dhe PEComa e vendosur në ose e lidhur ngushtë me mitrën.

3. Kompozimi për përdorim i pretendimit 1 ose 2, ku PEComa është e paheqshme, e paheqshme e lokalizuar, e avancuar, e avancuar lokalisht, metastatike ose e përsëritur.

4. Kompozimi për përdorim i çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 3, ku doza e sirolimusi e administruar te individi është 100 mg/m², 75 mg/m², 56 mg/m² ose 45 mg/m².

5. Kompozimi për përdorim i çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 4, ku metoda përfshin administrimin e kompozimit të nanogrimcës çdo javë; në mënyrë të preferuar ku metoda përfshin administrimin e kompozimit të nanogrimcës 2 në çdo 3 javë.

6. Kompozimi për përdorim i çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 5, ku metoda përfshin administrimin e kompozimit të nanogrimcës në ditët 1 dhe 8 të një cikli 21-ditor.

7. Kompozimi për përdorim i çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 6, ku nanogrimcat kanë një diametër mesatar prej jo më të madh se 150 nm; në mënyrë të preferuar ku nanogrimcat kanë një diametër mesatar prej jo më të madh se 120 nm.

8. Kompozimi për përdorim i çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 7, ku sirolimusi është i lidhur me albuminën, në mënyrë të preferuar ku albumina është albuminë njerëzore, më tej në mënyrë të preferuar albuminë e serumit njerëzor.

9. Kompozimi për përdorim i pretendimit 8, ku raporti i peshës i albuminës dhe sirolimusi në kompozimin nanogrimcor është 1:1 deri në 9:1, në mënyrë të preferuar 9:1.

10. Kompozimi për përdorim i çdo njërit prej pretendimeve 1 dhe 3 deri në 9, ku individi është njeri, ose ku individi është të paktën 50 vjeç.

11. Kompozimi për përdorim i çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 10, ku metoda më tej përfshin zgjedhjen e individit për trajtim bazuar në një nivel të një shënuesi melanocitik dhe një shënuesi të muskujve të lëmuar; në mënyrë të preferuar ku individi ka një nivel të lartë të shënuesit melanocitik dhe shënuesit të muskujve të lëmuar; dhe/ose në mënyrë të preferuar ku shënuesi melanocitik është zgjedhur nga grupi i përbërë prej HMB45, MelanA, dhe faktori i transkriptimit të mikroftalmisë; dhe/ose në mënyrë të preferuar ku shënuesi i muskujve të lëmuar është zgjedhur nga grupi i përbërë prej aktinës së muskujve të lëmuar, aktinës pan-

muskulore, h-kaldesmonës, dhe kalponinës; dhe/ose në mënyrë të preferuar ku niveli i shënuesit melanocitik dhe shënuesi i muskujve të lëmuar është përcaktuar nga imunohistokimia.

12. Kompozimi për përdorim i çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 11, ku metoda më tej përfshin zgjedhjen e individit për trajtim bazuar në statusin e mutacionit të një gjeni të zgjedhur nga grupi i përbërë prej TSC1, TSC2, TFE3, RHEB, MTOR, AKT, PIK3CA, dhe PTEN; në mënyrë të preferuar ku individit është zgjedhur për trajtim nëse individit ka një mutacion në gjen; dhe/ose në mënyrë të preferuar ku statusi i mutacionit të gjenit është përcaktuar nga sekuencimi i gjenit.

13. Kompozimi për përdorim i çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 12, ku metoda më tej përfshin zgjedhjen e individit për trajtim bazuar në statusin e fosforilimit të një proteine të zgjedhur nga grupi i përbërë prej AKT, S6, S6K, dhe 4EBP1.

14. Kompozimi për përdorim i çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 13, ku metoda më tej përfshin zgjedhjen e individit për trajtim bazuar në një nivel të një shënuesi proliferimi dhe/ose një shënuesi apoptoze; në mënyrë të preferuar ku shënuesi i proliferimit është Ki-67; dhe/ose në mënyrë të preferuar ku shënuesi i apoptozës është PARP ose një fragment i tij; dhe/ose në mënyrë të preferuar ku niveli i shënuesit të proliferimit dhe shënuesit të apoptozës është përcaktuar nga imunohistokimia.

15. Kompozimi për përdorim i çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 14, ku individit nuk është trajtuar më parë me një frenues mTOR; ose ku individit është rezistent ndaj një trajtimi me një formulim jo-grimcor të një frenuesi mTOR.

(11) **12749**

(97) EP4241685/ 18.12.2024

(96) 23169503.2/ 20.12.2018

(22) 03.02.2025

(21) [AL/P/2025/70](#)

(54) **SISTEMI MJEKËSOR DHE METODA E PRODHIMIT TË TIJ**

03.03.2025

(30) EP 17209756 21/12/2017

(71) F. Hoffmann-La Roche AG/ Grenzacherstrasse 124 4070 Basel / CH

(72) KONYA, Ahmet/68305 Mannheim / DE.

(74) Eno Dodbiba // ZHEGU; Nd. 1; H. 1; Ap. 7; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 1; NJËSIA BASHKIAKE NR. 1; 1004; TIRANË.

(57) 1. Një sistem mjekësor (110) , që përbëhet nga

a. një fole (112) ;

b. një modul funksional i montuar paraprakisht (118) i vendosur në fole (112) , ku moduli funksional i montuar paraprakisht (118) përbëhet nga

b1. një sensor analitik (120) për gjurmimin e të paktën një analiti në lëngjet trupore të përdoruesit;

b2. një njësi elektronike (126) e lidhur elektrikisht me sensorin analitik (120) ;

b3. një komponent vendosjeje (130) për vendosjen e sensorit analitik (120) në indin e trupit të përdoruesit; dhe

b4. të paktën një kapak steriliteti (124) që mbështjell të paktën pjesërisht komponentin e vendosjes (130) ;

c. të paktën një kapak mbrojtës të lëvizshëm (134) që lidhet me folenë (112) , duke mbuluar

modulin funksional të montuar paraprakisht (118) , ku kapaku i sterilitetit (124) është i dallueshëm nga kapaku mbrojtës (134) ;

ku kapaku i sterilitetit (124) është konfiguruar për t'u tërhequr nga komponenti i vendosjes (130) kur kapaku mbrojtës (134) tërhiqet nga foleja (112) , ku kapaku i sterilitetit (124) është lidhur me kapakun mbrojtës (134) në skajin fundor të kapakut të sterilitetit (124) me një ose më shumë lidhje puthitëse nëpërmjet formës, lidhje puthitëse nëpërmjet forcës, ose një lidhje me përfshirje materiali.

2. Sistemi mjekësor (110) sipas pretendimit pararendës, ku kapaku i sterilitetit (124) është vendosur brenda kapakut mbrojtës (134) , ku një mur i kapakut të sterilitetit (124) është i ndryshëm nga një mur i kapakut mbrojtës (134) .

3. Sistemi mjekësor (110) sipas secilit prej pretendimeve pararendëse, ku kapaku mbrojtës (134) dhe kapaku i sterilitetit (124) përbëhen nga materiale të ndryshme.

4. Sistemi mjekësor (110) sipas secilit prej pretendimeve pararendëse, ku komponenti i vendosjes (130) përbëhet nga të paktën një kanulë e vendosjes (132) , me sensorin analitik (120) të vendosur pjesërisht aty, ku komponenti i vendosjes (130) përbëhet më tej nga të paktën një mbajtës (144) për kanulën e vendosjes (132) , ku mbajtësi (144) , kanula e vendosjes (132) dhe kapaku i sterilitetit (124) formojnë komponentët e një kontejneri steril për sensorin analitik (120) .

5. Sistemi mjekësor (110) sipas pretendimit pararendës, ku kapaku i sterilitetit (124) lidhet me kapakun mbrojtës (134) nëpërmjet një ose më shumë elementeve drejtuese për transformimin e lëvizjes së kapakut mbrojtës (134) në lëvizjen e dëshiruar të kapakut të sterilitetit (124) , ku kapaku i sterilitetit (124) nuk mund të hiqet nga mbajtësi (144) nëpërmjet një çelësi bajonetë.

6. Sistemi mjekësor (110) sipas secilit prej dy pretendimeve pararendëse, ku mbajtësi (144) përbëhet nga një komponent i palëvizshëm i lidhur me skajin afër qendrës të kanulës së vendosjes (132) .

7. Sistemi mjekësor (110) sipas secilit prej pretendimeve pararendëse, ku kapaku mbrojtës (134) hiqet nga foleja (112) duke e tërhequr atë (134) nga foleja (112) , e cila (112) përbëhet nga të paktën një sipërfaqe drejtuese (140) që drejton kapakun mbrojtës (134) gjatë tërheqjes së kapakut mbrojtës (134) .

8. Sistemi mjekësor (110) sipas pretendimit pararendës, ku moduli funksional i montuar paraprakisht (118) përfshin të paktën një sipërfaqe drejtuese për drejtimin e kapakut të sterilitetit (124) gjatë tërheqjes së kapakut të sterilitetit (124) nga komponenti i vendosjes (130) .

9. Sistemi mjekësor (110) sipas pretendimit pararendës, ku një gjatësi e sipërfaqes drejtuese (140) të folesë (112) tejkalon një gjatësi të sipërfaqes drejtuese për kapakun e sterilitetit (124).

10. Sistemi mjekësor (110) sipas secilit prej tre pretendimeve pararendëse, ku një gjatësi e sipërfaqes drejtuese (140) të folesë (112) tejkalon gjatësinë e kapakut të sterilitetit (124) , në mënyrë të tillë që kapaku i sterilitetit (124) të tërhiqet plotësisht nga komponenti i vendosjes (130) përpara se të përfundojë drejtimi i folesë (112) nga sipërfaqja drejtuese (140) kur kapaku mbrojtës (134) tërhiqet nga foleja (112) .

